

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI MJEKËSOR I TIRANËS  
FAKULTETI I MJEKËSISË

ASTMA NË ZONAT URBANE E RURALE TE FËMIJËT  
NDIKIMI I FAKTORËVE TË RREZIKUT NË  
PREVALENCËN E SËMUNDJES

DISERTACION I PARAQITUR PËR ARRITJEN E  
GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

UDHËHEQËS SHKENCOR  
PROF. DR. EVDA VEVEÇKA


KANDIDATI:  
DRITA TELAKU QOSAJ

TIRANË, 2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI MJEKËSOR I TIRANËS  
FAKULTETI I MJEKËSISË

ASTMA NË ZONAT URBANE E RURALE TE FËMIJËT  
NDIKIMI I FAKTORËVE TË RREZIKUT NË  
PREVALENCËN E SËMUNDJES



DISERTACIONI I PARAQITUR PËR ARRITJEN E  
GRADËS SHKENCORE "DOKTOR"

UDHËHEQËS SHKENCOR:  
PROF. DR. EVDA VEVÇKA

KANDIDATI:  
DRITA TELAKU QOSAJ

TIRANË, 2020

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI MJEKËSOR I TIRANËS  
FAKULTETI I MJEKËSISË

DISERTACION  
I PARAQITUR NGA:

DRITA TELAKU QOSAJ  
PËR MARRJEN E GRADËS SHKENCORE:  
DOKTOR

SPECIALITETI: PEDIATRI

ASTMA NË ZONAT URBANE E RURALE TE FËMIJËT  
NDIKIMI I FAKTORËVE TË RREZIKUT NË  
PREVALENCËN E SËMUNDJES

UDHËHEQËS SHKENCOR: prof.dr.EVDA VEVEÇKA

TIRANË, 2020

Shpjegimi i shprehjeve dhe shkurtesave të përdorura në këtë tekst

---

ISAAC-International Study of Asthma and Allergy in Childhood

BMI- Body Mass Index

BE- Bashkimi Europian

GDP-Gross Domestic Product

WHO-World Health Organisation

ERECa-Urban Environment and Childhood Asthma

NS-Not Significant

SC-Sectio Cesarea

UK-United Kingdom

TH- T Helper

VRS-Virusi Respirator Sincial

## PËRMBAJTJA

---

Parathënie .....	VI
------------------	----

### Kapitulli I: Të dhëna teorike mbi astmën e fëmijës dhe faktorët e rrezikut

1. Hyrje.....	VII
2. Faktorët e rrezikut të astmës te fëmijët.....	IX
2.1. Faktorët gjenetikë dhe ndërlidhja gjen-ambient.....	IX
2.2. Faktorët e rrezikut paralindjes.....	X
2.3. Faktorët e rrezikut në fëmijëri.....	XI
2.4. Ndjeshmëria alergjike.....	XIII
2.5. Ndikimi i ambientit të brendshëm dhe të jashtëm.....	XIV
2.6. Gjinia dhe astma.....	XV
2.7. Obeziteti dhe astma.....	XV

Kapitulli II: Qëllimi dhe objektivat.....	1
---	---

Kapitulli III: Materiali dhe metodat .....	2
1. Popullata e përzgjedhur dhe Metodologjia.....	2
2. Metoda statistikore.....	4

Kapitulli IV: Rezultatet dhe diskutimi .....	6
--	---

Kapitulli V: Përfundimet.....	49
-------------------------------	----

Bibliografia dhe anekset.....	51
-------------------------------	----

## ***Parathënie***

*Astma është sëmundje kronike inflamtoare që karakterizohet me obstrukcion difuz dhe variabël. Manifestohet me episode të përsëritura të fishkëllimës, kollës, frymëmarrje të vështërsuar dhe dhimbjes në gjoks.*

*Prevalenca e astmës ndryshon në vende të ndryshme të botës nga 2% deri në 40%. Në Kosovë nuk kemi të dhëna mbi prevalencën e astmës, në Shqipëri prevalenca është 3% që hyn në grupin e vendeve me prevalencë të ulët. Por studimet tregojn për rritje të prevalencës sidomos në vendet në zhvillim.*

*Astma përfshin një sërë fenotipash heterogjene që dallojnë nga mënyra e paraqitjes, etiologjia e fizpatologjia. Faktorët e rrezikut për çdo fenotip të njohur astmës përfshijnë faktorët gjenetikë, faktorët ambientat dhe faktorë të lidhur me bujtësin. Për më tepër këta faktorë mund të ndikojnë në astmë në mënyrë të ndryshme në kohë të ndryshme të jetës së një individi, dhe për më tepër mund të ndryshojn me kohën.*

*Në studimin tonë kemi studiuar një sërë faktorësh rreziku që i kemi ndarë në faktorët para lindjes, faktorët e rrezikut në fëmijëri, faktorët ambientit të brendshëm dhe të jashtëm.*

*Kosova karakterizohet me ndryshime të mëdha në drejtim të urbanizimit dhe mënyrës së jetesës, pjesa më e madhe e popullatës ende jeton në vende rurale, tipare demografike ku kemi popullatë të re, jetesa në familje të mëdha sidomos në vendet rurale, nivel të ulët socio ekonomik.*

*Analizimi i këtyre faktorëve të rrezikut duke krahasuar fëmijët varësisht nga zonat që vijn, urbane dhe rurale ,do të na jep të dhëna për astmën në Kosovë. Duke analizuar prevalencën ,gravitetin dhe kontrollin e astmës te fëmijët në Kosovë dhe faktorët e rrezikut prezent do të ndihmoj të kemi të dhëna që të evitojm këta faktorë rreziku si dhe të ndihmojn në formulimin e strategjive nacionale për menaxhimin e astmës në vendin tonë.*

# KAPITULLI I

## TË DHËNA TEORIKE MBI ASTMËN E FËMIJËS DHE FAKTORËT E RREZIKUT

### 1.Hyrje

Astma e fëmijës është një ombrellë nën të cilën hyjnë sëmundje të shkaktuara nga shumë faktorë që kanë tipare të përbashkëta si infiltrimi mast-cell dhe eozinofilik që çojnë në mbindjeshmëri të rrugëve ajrore, inflamacion dhe obstrukcion të tyre. Në patogjenezën e astmës ndërhyjnë një sërë faktorësh. Bashkëveprimi i predispozicionit gjenetik dhe ngacmuesve ambiental ndikojnë në ndryshimet e polarizimit të sistemit imun drejt përgjigjes me celulat T helper (Th) të tipit 2, që përfshin prodhimin e citokinave pro-inflamatore, të IgE dhe infiltrateve eozinofilike; të gjitha këto të pranishme në astmë. (1,2)

Astma është sëmundja kronike më e shpeshtë në moshën fëmijërore me një prevalencë që vjen duke u rritur në të gjithë botën. Nxitësit ambiental në periudhën prenatale, perinatale dhe fëmijërinë e hershme duket se përcaktojnë zhvillimin e astmës, incidencën dhe mbrojtjen ndaj saj. Mënyra e lindjes, përdorimi i antibiotikëve, stresi, ekspozimi ndaj tymit të duhanit dhe mënyra e individualizimit të jetës janë ndikues të rëndësishëm në akutizimet e astmës te fëmijët (3)

Astma ka një shpërndarje të ndryshme në vende të ndryshme dhe për më tepër në të njëjtin vend, ajo ndryshon në varësi të shumë faktorëve. Prevalenca e astmës te fëmijët në botë, sipas ISAAC (International Study of Astma and Allergy in Childhood) varion sipas vendit nga 2% ne 40%. Në Kosovë nuk kemi të dhëna për prevalencën e astmës, por në Shqipëri , gjithmonë sipas ISSAC , ajo është 3%. (4)

Rritja e rëndësishme e prevalencës së Astmës në të gjithë botën ka çuar një sërë studimesh për të shpjeguar arsyet e kësaj gjendje. Midis këtyre studimeve dy zënë vendin kryesor njëri i kryer në moshën fëmijërore: International Study of Astma and Allergy in




Figura 1: Asthma: epidemiology, etiology and risk factors

(Padmaja Subbarao MD MSc, Piush J. Mandhane MD PhD, Malcolm R. Sears MB ChB  
*CMAJ*2009. DOI:10.1503/cmaj.080612)



Childhood (ISAAC) dhe tjetri i kryer në adultët e rinj: European Community Respiratory Health Survey.(5) Gjatë një periudhe 7 vjeçare nga faza e parë e studimit ISAAC, i cili në pjesën më të madhe të vendeve u krye në vitet 1991-1993, prevalenca e astmës në disa vende të botës ka qëndruar e pa ndryshuar, por në disa të tjera është rritur në mënyrë të rëndësishme, sidomos në fëmijët 13-14 vjeç (Figura 1.)(6)

Vëzhgimet në popullatat që kanë emigruar mbështesin fort rolin e faktorëve lokalë ambiental në të cilët përfshihen alergjenet por edhe shumë faktorë të mënyrës së jetesës të cilët mund të jenë (7) përcaktues në shkallën e shprehjes së Astmës në popullata gjenetike të njejta (8). Kosova është një vend që ka pësuar ndryshime të mëdha. Në Kosovë regjistrimi i fundit i popullsisë është bërë në vitin 2011, pas 30 vitesh ( regjistrimi i mëparshëm ka qenë në vitin 1980). Numri total i banorëve është 1739.825 me dendësi të popullësisë prej 163.2 banorë /km<sup>2</sup>. Në Kosovë 38% e popullësisë jeton në zona urbane dhe 62% në zona rurale (9). Familjet në Kosovë karakterizohen nga familje të mëdha, me një numër mesatar të anëtarëve në një ekonomi familjare 5.9 anëtarë.(9)

Bazuar në këto veçori ndërtoam hipotezën kryesore të këtij studimi për të parë nëse do të kishim ndryshime në astmën e fëmijëve në varësi të rajonit urban/ rural në Kosovë.

## **2.Faktorët e rrezikut të Astmës pediatrike**

Astma përfshin një sërë fenotipash heterogjene që dallojnë nga mënyra e paraqitjes, etiologjia e fizpatologjia. Faktorët e rrezikut për çdo fenotip të njohur të astmës përfshijnë faktorët gjenetikë, faktorët ambiental dhe faktorë të lidhur me bujtësin. Historia familjare për astmë/ atopi zakonisht gjendet te fëmijët me astmë, por ajo nuk është e mjaftueshme dhe as e domosdoshme për diagnozën e astmës te fëmija. Rritja e rëndësishme e incidencës së astmës pediatrike në dekadat e fundit, variacionet e prevalencës së saj në botë, mbështesin tezën se ndryshimet ambiental luajnë një rol të rëndësishëm në astmë. Këta faktorë mund të ndikojnë në zhvillimin e astmës në mënyrë të ndryshme në kohë të ndryshme të jetës së një individi, dhe për më tepër, mund të ndryshojnë me kohën.

### **2.1. Faktorët gjenetikë dhe ndërlidhja gjen – ambient**

Studimet kanë treguar se gjenet janë përgjegjëse për zhvillimin e astmës dhe alergjisë (10). Deri tani janë identifikuar më shumë se 100 gjene që lidhen me alergjinë dhe astmën (11). Gjeneri i ri i identifikuar, ORMDL3 ka treguar të ketë një lidhje të lartë me astmën. (12) Për më tepër gjene të ndryshme janë të lidhura me grupe të ndryshme etnike. Fëmijët e dy prindërve me astmë kanë mundësi 2 herë më shumë të zhvillojnë astmë, dhe fëmijët të cilët përveç prindërve kanë me astmë edhe gjyshin /gjyshen kanë mundësi 4 herë më shumë të zhvillojnë astmë (13).

Janë bërë përparime në gjetjen e gjeneve candidate të lidhur me astmën, por ende nuk ka një test të përdorshëm në praktikë. Pasojat e ndërlidhjes gjene –ambient janë shumë komplekse. Në disa raste gjenet kodojnë për enzima që detoksikojnë agjentët inhalatore,

ndërkohë që në raste të tjera ekspozimi ndaj këtyre agjentëve mund të ndikojë direkt në shprehjen e gjenit (14). Është hedhur idea, se fakti që stili i jetës dhe ekspozimi ndaj kimikateve ndikojnë në zhvillimin e sëmundjes, është e lidhur me modifikimet epigjenetike të DNA (15). Nutricioni dhe dieta, pirja e duhanit, stresi te nëna janë faktorë që mund të ndikojnë në shprehjen gjenetike të fetusit dhe të një mundësie të mëvonshme për ndikimin e faktorëve të ndryshëm ambiental në zhvillimin e alergjisë dhe astmës.

## 2.2. Faktorët e rrezikut paralindjes

Faktorët e rrezikut paralindjes janë të shumëfishtë dhe vlerësimi i tyre shpesh i ndërlikuar për shkak se shumë gjendje që shoqërohen me fishkëllima në periudhën e fëmijërisë së hershme, mund të jenë kalimtare dhe vetëm një pjesë e tyre përparojnë drejt astmës klasike. Do të analizojm disa prej tyre

### Duhan pirja nga nëna gjatë shtatzënisë

Studimet tani më kanë treguar një lidhje të qartë midis fishkëllimave të fëmija i vogël dhe pirjes së duhanit nga nëna gjatë shtatzënisë. Ky ndikim i duhanpirjes gjatë shtatzënisë shtohet kur fëmija ekspozohet ndaj tymit të duhanit edhe pas lindjes. (3)

### Dieta dhe gjendja nutricionale e nënës shtatzënë

Studimet janë përqëndruar kryesisht në drejtim të lidhjes së mundshme midis sëmundjeve atopike dhe ushqimeve me veti anti inflamatore (acidet yndyrore omega 3) dhe atyre me veti antioksiduese (vitamina E dhe Zinku). Disa prej këtyre studimeve kanë treguar se ushqyerja më e madhe me peshk dhe vaj peshku gjatë shtatzënisë shoqërohet me rrezik më të vogël për atopi të fëmijët deri 6 vjeç (16) Po ashtu marrja e vitaminës E dhe zinkut nga nëna shoqërohet me më pak fishkëllima të fëmijët deri në 5 vjeç (18). Sidoqoftë përjashtimi nga dieta e nënave shtatzënë i disa ushqimeve si qumështi, vezët nuk ka treguar ndikim mbrojtës ndaj atopisë të fëmija (19,20) Studime të fundit kanë treguar një lidhje midis nivelit të vitaminës D të nënave shtatzënë dhe atopisë, astmës dhe fishkëllimave në fëmijërinë e hershme, por jo më vonë gjatë jetës. (21,22)

### Përdorimi i antibiotikëve gjatë shtatzënisë

Studimet kanë treguar një rrezik më të madh për fishkëllima persistente të fëmijët e lindur nga nënat që gjatë shtatzënisë kanë përdorur antibiotikë. (23,24). Për më tepër ky rrezik i shtuar lidhet edhe me dozën dhe numrin e rasteve të përdorimit të tyre (25, 26)

## Kontakti i nënës me kafshët shtëpiake gjatë shtatzënisë

Studimet në komunitetet që jetojnë në ferma kanë treguar se fëmijët në këto komunitete kanë më pak astmë. Mendohet se ka disa faktorë që shpjegojnë këto gjetje si ekspozimi i nënave gjatë shtatzënisë ndaj kafshëve shtëpiake . Faza e tretë e studimit ISSAC (Phase Three of the International Study of Asthma and Allergies in Childhood - ISSAC) tregoi se ekspozimin ndaj kafshëve gjatë shtatzënisë shoqërohet me më shumë simptoma të astmës te fëmijët që jetojnë në vende të varfëra ndërkohë që është e kundërta në vendet e pasura (27). Poashtu ka studime që tregojn se kontakti me kafshë gjatë shtatzënisë dhe fëmijërisë zvogëlon rrezikun e ndjeshmërisë alergjike dhe shfaqjes së astmës atopike, por shton rrezikun e astmës joatopike,(28,29)

## Mënyra e lindjes dhe pesha e lindjes

Në dekadat e fundit vërehet një rritje e përqindjes së fëmijëve të lindur me sektio cezarea (Sectio Cesarea) përtej nivelit të rekomanduar nga OBSH prej 15%. Rritja është vërejtur kryesisht në vendet e zhvilluara si SHBA, Angli, etj. Gjatë kësaj periudhë gjithashtu është vënë re një rritje e prevalencës së astmës dhe alergjisë në këto vende, duke bërë që një sërë studimesh të vlerësojnë një mundësi të lidhjes së mënyrës së lindjes dhe astmës. Fëmijët e lindur me sektio cezarea urgjente kanë më shumë atopi krahasuar me fëmijët e lindur me rrugë natyrale. Një lidhje e tillë nuk është vërejtur për fëmijët e lindur me sektio cezarea elektive (30).

Arsyet e mundshme për të shpjeguar këto të dhëna janë menduar të jenë të lidhura me mekanizma imunologjik kryesisht të fokusuar në faktin që fëmijët e lindur me sektio cezarea janë të privuar nga ekspozimi ndaj florës vaginale dhe intestinale të nënës që është parë të shoqërohet me ndryshime në mikroflorën dhe citokinat neonatale, që si pasojë shkaktojnë ndryshime në balancin e celulave ndihmëse Th1/Th2 dhe rrezikun për zhvillimin e atopisë. Sidoqoftë studimet epidemiologjike nuk kanë treguar gjetje të qëndrueshme (31). Sa i përket peshës së lindjes nuk ka lidhshmëri pesha e ulët e lindjes ( jashtë lindjes premature) me rrezikun e paraqitjes së astmës. Fëmijët me peshë lindje të madhe mbi 4.5 kg paraqiten më shumë të mjeku për arsye të fishkëllimave dhe sipas disa punimeve këta fëmijë kanë më shumë mundësi të zhvillojnë më vonë astmë (32,33,34).

## 2.3. Faktorët e rrezikut në fëmijëri

### Fenotipi i Astmës

Tashmë dihet se rreth gjysma e fëmijëve të moshës parashkollore mund të zhvillojnë fishkëllima gjatë jetës së tyre, por vetëm 10-15 % e tyre zhvillojnë astmë të vërtetë në moshën shkollore.(35) Sot njihen fenotipat e fishkëllimave në fëmijëri si fishkëllima të

rastësishme dhe fishkëllima që persistojnë, të cilat mund të jenë me fillim të hershëm, të ndërmjetëm apo të vonshëm. Fenotipi më i lidhur me astmën është ai i fishkëllimave që persistojnë me fillim të hershëm. Pjesa më e madhe e fëmijëve me fishkëllima persistente dhe që zhvillojnë astmë të vërtetë i kanë simptomat e para pa mbushur 3 vjeç(36).

## Ushqyerja me gji

Ndikimi i ushqyerjes me gji në rrezikun për atopi dhe astmë mbetet i diskutueshëm.(37,38,39) Sidoqoftë mendimi i shumicës është se ushqyerja vetëm me gji për të paktën 3 muajt e parë të jetës shoqërohet me frekuencë më të ulët të astmës (30) në moshat deri 5 vjeç. Roli shmangës nga dieta e nënës e alergjeneve kryesore ushqimore gjatë ushqyerjes me gji, gjithashtu është i diskutueshëm. Disa studime kanë treguar se shmangia nga dieta e nënës e qumështit, vezëve dhe peshkut shoqërohet me pakësim të dermatitit atopik te fëmija (40,41), por studime të tjera nuk kanë gjetur lidhje (42,43).

## Funksioni i mushkërisë

Kalibri i vogël rrugëve ajrore në fëmijëri është raportuar si një faktor rreziku për fishkëllima (44,45). Për më tepër studimet kanë treguar se prania e rrugëve ajrore me kalibër të pakësuar për shkaqe të ndryshme ( displazi bronkopulmonare, fibroze kistike, etj.) lidhet me një rritje të mbindjeshmërisë bronkiale dhe fishkëllimave (46). Roli i vërtetë i këtij faktori rreziku, pa praninë e atopisë nuk është i qartë; mendohet se individët me rrugë ajrore më të vogla kërkojnë stimuj më të pakët për të zhvilluar simptoma.

## Struktura familjare

Madhësia e familjes si dhe numri i rënditjes së fëmijës mund të ndikojë në rrezikun për astmë. Hipoteza e higjienës mbështetet në faktin se ekspozimi i fëmijës ndaj infeksioneve dhe bakterieve stimulon zhvillimin e sistemit imunitar ndaj fenotipit jo atopik.(47) Kjo teori mund të thjeshtohet në botën reale në vëzhgimin e familjeve të mëdha, ku fëmija më i vogël në familje pritet të ketë një rrezik më të pakët për astmë krahasuar me fëmijën e parë për shkak të ekspozimit më të madh ndaj infeksioneve të fëmijëve më të rritur që frekuentojnë ambientet publike(48). Ndonëse kjo teori është mbështetur nga disa studime mbi prevalencën e alergjisë (49), ajo është rrëzuar pjesërisht nga studimet e fundit mbi prevalencën e astmës që tregojnë se fëmijët e rritur në familje të mëdha kanë rrezik më të vogël për astmë, por radha e lindjes ndikon (50,51).

Dyshimet mbi hipotezën e higjienës mbështeten edhe nga fakti se infeksionet në vetvete nuk shpjegojnë disa veçori epidemiologjike p.sh. prevalencën e lartë për alergji dhe astmë në disa vende të Amerikës së Jugut ku ekspozimi ndaj infeksioneve është shumë më i lartë edhe se në vendet me prevalencë më të ulët të astmës (52). Për më tepër, jo vetëm sëmundjet alergjike por edhe ato autoimmune dhe sëmundjet e tjera kronike inflamatorë janë duke u rritur, një prirje kjo që është e vështirë të shpjegohet vetëm me hipotezën e higjienës, duke qenë se sëmundjet alergjike dhe ato immune shoqërohen me fenotipa imunologjikë konkurrues.(53)

## Gjendja social ekonomike

Fëmijët e prindërve me nivel të ulët socio-ekonomik kanë një sëmundshmëri më të madhe nga astma, por për sa i përket prevalencës, kjo është e variueshme (54) Ndikimi i gjendjes social ekonomike në prevalencën dhe sëmundshmërinë nga astma është e varur dhe nga mënyra se si është matur niveli socio-ekonomik. Sidoqoftë studimet kanë raportuar lidhje midis nivelit të ulët të gjendjes social ekonomike dhe simptomave të astmës por jo lidhje me diagnostikimin më të madh të astmës. (55).

Republika e Kosovës sipas Bankës Botërore është një shtet me të ardhura të mesme të ulëta. Ajo ka një shkallë të lartë papunësie. Në Kosovë nga popullata totale aktive rreth 35% deri 39% janë të papunë. (56). Në Kosovë 34.5 % e popullatës jeton në vafëri dhe 12.1% në varfëri të skajshme. Të ardhurat mesatare në sektorin publik janë 368 euro në muaj. GDP per capita është 3.400, krahasuar me BE dhe vendet e rajonit është më e ulëta (BE 31.700, Slovenia 22.700, Kroacia 12.800, Maqedonia 4.900, Bosna dhe Hercegovina 4.300, Shqipëria 4.100) (57). Nëse krahasohet vafëria sipas vendbanimit ajo dominon në vendet rurale me 62.6% në krahasim me vendet urbane me 47.4%. (58).

## Infeksionet dhe antibiotikët

Disa studime kanë treguar se përdorimi i antibiotikëve shoqërohet me fishkëllima në moshën fëmijërore por studimet nuk kanë gjetur një shtim të incidencës së atopisë me përdorimin e antibiotikëve (59,60,61). Është hedhur idea se përdorimi i madh i antibiotikëve më tepër se i lidhur me fishkëllimat, është tregues i numrit të madh të infeksioneve që fëmija ka kaluar ( edhe virale që shoqërohen me fishkëllima) (62).

Infeksionet respiratore të fëmijët janë të lidhura me fishkëllima sidomos në moshën parashkollore. Mbetet i diskutueshem fakti nëse këto infeksione i japin zanafillën ndjeshmërisë ndaj aeroalergjeneve dhe fëmijët më vonë zhvillojnë astmë. Infeksionet virale te fëmijët e vegjël mund të jenë shkaktarë patogjenë në disa raste dhe mbrojtës në disa të tjera (63,64,65). Sipas disa punimeve ekspozimi i hershëm ndaj infeksioneve bakteriale dhe alergjeneve të ndryshëm zvogëlon rrezikun për sëmundje atopike (66,67). Fëmijët e nënave me alergji ose astmë kanë një deficit relativ në sintetizën e citokinave Th1 në vitin e parë të jetës dhe mendohet se ky fakt mund të ndikojë në zhvillimin e infeksioneve virale perzistente apo të rënda (68,69).

Lidhja e përkeqësimit të simptomave të astmës me infeksionet virale te fëmijët është e vërtetuar tashmë që prej 30 vitësh, nëpërmjet metodave që përdorin kulturat apo metodat serologjike. Kjo lidhje është konfirmuar edhe kohët e fundit nëpërmjet metodave të reja më të shpejta dhe më të ndjeshme të zbulimit të viruseve (RT, PCR) . Virusi i gjetur më shpesh është Rinovirusi për mënyrën e veprimit të të cilit në shpërthimin e acarimeve të astmës janë publikuar mjaft punime (70,71,72)

## 2.4. Ndjeshmëria alergjike

Ndjeshmëria alergjike njihet si një faktor i rëndësishëm rreziku për astmë(73) Sidoqoftë është e domosdoshme të theksohet se prania e antikorpeve IgE pasqyron një përgjigje imune sistemike, e cila mund të jetë ose jo e lidhur me astmën dhe për më tepër, edhe në individët me astmë atopike, ndjeshmëria me ndërmjetësimin e IgE është një gjetje e cila jo gjithmonë ndikon direkt në praninë apo gravitetin e simptomave klinike (74,75) Ndjeshmëria në vetvete në mungesë të ekspozimit ndaj alergjenit ka pak ndikim në simptomat klinike të fëmijët e vegjël. Kombinimi i ndjeshmërisë ndaj një alergjeni dhe ekspozimi ndaj tij zakonisht shoqërohet me një evolucion më të keq të astmës (76)

Sot ka shumë studime që mbështesin rolin e ndjeshmërisë atopike në incidencën e astmës, por ndjeshmëria alergjike nuk është e domosdoshme për zhvillimin e astmës. Përgjigjia me antikorpe IgE nuk tregon një fenotip të vetëm të atopisë. Ajo tregon disa fenotipa të ndjeshmërisë atopike që ndryshojnë në lidhjen e tyre me fenotipat e astmës. Alergjenët si ata jashtë shtëpisë ashtu edhe ata brenda saj mendohet se shkaktojnë riakutizime të astmës, por roli i tyre direkt në zhvillimin e astmës nuk është i qartë. Lidhshmëria mes ekspozimit ndaj alergjenit dhe senzibilizimit tek fëmijët nuk është i drejtpërdrejtë. Ai do të varet nga alergjeni, doza, koha e ekspozimit, mosha e fëmijës e po ashtu edhe faktorët gjenetikë.

## 2.5. Ndikimi i ambientit të brendshëm dhe të jashtëm

Në përgjithësi astma është më e shpeshtë dhe me gravitet më të madh në vendet me dendësi më të madhe të popullatës. Po ashtu përshtatja me stilin urban perëndimor të jetës shoqërohet me rritjen e prevalencës së saj. (77,78). Kontakti i hershëm me një ambient të pasur për sa i përket ekspozimit ndaj mikrobeve në ferma mund të jetë mbrojtës dhe mendohet se është pasojë e pranisë së endotoksinës në këto ambiente. Endotoksina është polisaharid dhe gjendet në muret qelizore të shumë bakterieve dhe në ambientin e jashtëm gjendet me shumë në pluhurin e hambareve, shtallave dhe fecet e kafshëve. (79,80).

Astma, riniti dhe atopia më shumë raportohet tek fëmijët e vendeve urbane se sa atyre rurale. Por ka edhe punime që tregojnë prevalencë më të lartë të astmës tek fëmijët që jetojnë në vende rurale (7) Faktorët ambiental që përcaktojnë alergjinë e ushtrojnë ndikimin e tyre para shfaqjes së manifestimeve klinike që gjatë shtatzënisë dhe fëmijërisë së hershme, nëpërmjet ndikimit në maturimin e sistemit imunitar. Ka disa faktorë të lidhur me stilin e jetës që mund të nxisin zhvillimin e Astmës. Studimi ERECA (Urban Environment and Childhood Asthma) ka për qëllim të përcaktojë mekanizmat nëpërmjet të cilave stili i jetës specifik urban ndikon në zhvillimin imunitar në fëmijërinë e hershme dhe lidhjen e kësaj me rrezikun për të zhvilluar astmë.

## Ekspozimi ndaj tymit të duhanit në ambient

Ekspozimi i fëmijës ndaj tymit të duhanit pas lindjes, sidomos kur nëna është duhanpirëse gjithmonë shoqërohet me shtim të simptomave respiratore dhe astmë (3,81). Për më tepër ekspozimi ndaj tymit të duhanit shoqërohet dhe me keqësimin e simptomave të astmës dhe është faktor rreziku për astmë të rëndë (82,83). Mendohet se ekspozimi në duhanpirje redukton funksionin e Th1 qelizave me këtë edhe luftimi i infeksioneve respiratore (84,85)

## Ekspozimi ndaj kafshëve shtëpiake

Mjaft studime kanë treguar se individët e ekspozuar që herët në jetë ndaj kafshëve të fermave kanë një rrezik më të pakët për të zhvilluar atopi dhe astmë (86,87), ndërkohë që studimet mbi ndikimin e kafshëve shtëpiake (qen ,mace) në gjendjen atopike dhe në zhvillimin e astmës janë kundërshtuese. Në disa studime ekspozimi ndaj maceve ka treguar rrezik të rritur për atopi (88), ndërkohë që studime tjera kanë treguar rrezik të pakët (89,90). Po ashtu mjaft studime tregojnë se ekspozimi ndaj qenit mund të jetë mbrojtës jo vetëm në drejtim të ndjeshmërisë ndaj qenit, por edhe ndaj alergjeneve të tjerë si akarienët (91,92).

## Air-Pollution

Roli i ndotjes së ajrit në zhvillimin e astmës nuk është i përkufizuar mirë. Ndotja e ajrit mund të jetë në ambientet e brendshme të shtëpisë, të vendit të punës, në shkollë, çerdhe apo ndotja e ambientit të jashtëm (93). Ndotja e ambientit të jashtëm është përcaktuar sipas OBSH-së me 4 tregues kryesore: materiet grimcore, ozoni i nivelit tokësor, dioksidi i sulfurit dhe dioksidi i azotit.

Për lidhjen midis ndotjes atmosferike dhe astmës është folur mjaft sidomos në vendet me urbanizim dhe industrializim të shpejtë. Tre studime të mëdha të bëra në Europë dhe Australi kanë raportuar një lidhje të përgjithshme jo sinjifikante midis ndotësve kryesorë të ambientit dhe vizitat për astmë në urgjencë, ndërkohë që studime të tjera në Europë ,Kinë, Kore, Japoni kanë treguar lidhje të variueshme midis acarimeve të astmës dhe ndotjes nga ozoni dhe dioksidi i sulfurit (94,95,96,97,98,99,100).

Për sa i përket cilësisë së ajrit në Kosovë kemi disa të dhëna për Prishtinën dhe Drenasin, ku janë bërë përpjekje për të analizuar cilësinë e ajrit duke i krahasuar me standartet e Bashkimit Europian dhe duke i analizuar vlerat e fituara me standartet e BE. Kështu materiet grimciore PM 10 gjatë vitit 2010 , 2011 kanë treguar vlera të rritura të vlerës kufitare ditore për 35 ditë brenda vitit. Numri më i madh i ditëve me tejkalime të vlerës mesatare ditore ka qenë gjatë muajve të dimrit. Matja e nivelit të materieve grimcore PM 2.5 ka treguar rritje prej vitit 2010 në vitin 2011 me kalim të vlerës mesatare prej 25 mikr/m<sup>3</sup>. Gjatë muajve të verës kemi ngritje të koncentrimin të ndotjes me ozon si pasojë e

rrezatimit më të madh të diellit. Vlera mesatare e NO<sub>2</sub>, SO<sub>2</sub>, CO nuk kanë tejkaluar vlerat kufitare të lejuara (100).

## **2.6. Gjinia dhe astma**

Të dhënat mbi ndikimin e gjinisë në zhvillimin e astmës janë shpesh kundërshtuese. Shumica e punimeve tregojnë se gjinia ndikon në zhvillimin e astmës në mënyrë të ndryshme në mosha të ndryshme. Deri në moshat 13-14 vjeç incidenca dhe prevalenca e astmës është më e lartë në djemtë se në vajzat. (102,103,104) Gjatë pubertetit është vërejtur një incidencë më e madhe e astmës në femrat (105,106) si dhe një numër më i madh remisiolesh nga astma te djemtë (107,108).

## **2.7. Obeziteti dhe astma**

Në literaturë kemi mjaft punime që flasin për lidhjen e obezitetit me astmën. Mënyra se si obeziteti ndikon në zhvillimin e astmës nuk dihet me siguri por mendohet se vepron së bashku me faktorët tjerë. Obeziteti mund të ndikojë në funksionin e rrugëve të frymëmarrjes duke zhvilluar një gjendje proinflatore. Lirimi i citokineve proinflatore dhe mediatorëve të ndryshëm si interleukina 6, faktori i tumor nekrozës, eotaxin dhe leptin dhe kombinuar me nivel më të ulët të adipokineve antiinflatore te personat obez do të zhvillojë një gjendje proinflatore (109,110).





## KAPITULLI II: QËLLIMI DHE OBJEKTIVAT

### Qëllimi kryesor:

*Studimi i ndyshimeve në fëmijët me astmë që jetojnë në zonat urbane krahasuar me ata që jetojnë në zonat rurale, duke vlerësuar faktorët e mundshëm që mund të kenë ndikuar*

### Objektivat:

1. Vlerësimi i prevalencës së astmës, gravitetit dhe kontrollit të saj në fëmijët e zonave urbane krahasuar me ato rurale
2. Vlerësimi i ndikimit të faktorëve të rrezikut paralindjes si : atopia në familje, duhanpirja nga nëna gjatë shtatzënisë, përdorimi i antibiotikëve gjatë shtatzënisë, mënyra e lindjes dhe pesha në lindje, në prevalencën e astmës në zonat urbane krahasuar me ato rurale
3. Vlerësimi i ndikimit të faktorëve të rrezikut në fëmijëri si: koha e fillimit të simptomave, ushqyerja me gji, struktura familjare, arsimimi i prindërve, përdorimi i antibiotikëve, ekspozimi ndaj tymit të duhanit, ekspozimi ndaj kafshëve shtëpiake, në prevalencën e astmës në zonat urbane krahasuar me ato rurale
4. Vlerësimi i ndikimit të ndjeshmërisë alergjike në prevalencën e astmës në zonat urbane krahasuar me ato rurale
5. Vlerësimi i ndikimit të gjinisë dhe obezitetit në prevalencën e astmës, në zonat urbane krahasuar me ato rurale
6. Vlerësimi i ndikimit të ambientit të brendshëm në prevalencën e astmës në zonat urbane krahasuar me ato rurale
7. Vlerësimi i ndikimit të ambientit të jashtëm në prevalencën e astmës në zonat urbane krahasuar me ato rurale

# KAPITULLI III: MATERIALI DHE METODAT

## 1. Popullata e përzgjedhur dhe Metodologjia

- Studimi është prospektiv, i randomizuar, përzgjedhja e popullatës e rastësishme.
- Në studim janë përfshirë 178 fëmijë të moshave 0-16 vjeç të diagnostikuar për astmë në Klinikën e Pediatriës të Qendrës Klinike Universitare në Prishtinë nga Shtatori 2010 deri Shtator 2013
- Diagnoza e Astmës është bazuar në GLOBAL STRATEGY FOR ASTHMA MANAGEMENT AND PREVENTION Revised 2006, dhe GUIDLINE FOR THE DIAGNOSIS AND MANAGEMENT OF ASTHMA Full Report 2007 National Asthma Education and Prevention Program National Heart, Lung and Blood institute (Shih tabelat ne aneksin bashkangjitur në fund).
- Spirometria është realizuar me anë të spirometrit MIR Spirolab III. Është përdorur kurba Flow/ Volume për fëmijët që bashkëpunojnë midis 5-7 vjeç (FEV1: 80% e parashikimit e rikthyeshme pas bronkodilatimit me 12 %, 200ml, ose 10% e parashikimit). Testi normal nuk e ka përjashtuar astmën sidomos në format intermitente dhe të buta, kur fëmija ka qenë jashtë krizës apo i kontrolluar
- Përcaktimi i gjendjes alergjike është bërë te fëmijët e moshës 3 vjeç e sipër : është bërë nëpërmjet Prick –test (Papula të paktën 3 mm), për alergjenet respiratore kryesore (dermatofagoide,epitele të kafshëve,barëra, polene, mykra), dhe ushqimore kryesore ( Qumesht, veze, fruta te thata, mish, peshk)
- Janë përjashtuar nga studimi të gjithë fëmijët me Aspirime të përsëritura, Fibrozë kistike, Displazi bronkopulmonare, Aspirim të trupave të huaj, Anomali të lindura. Janë përjashtuar gjithashtu edhe rastet kur diagnoza ka qenë e dyshimtë (bëhet fjalë për fëmijët nën 5 vjeç kur ka qenë i nevojshëm rivlerësimi i diagnozës si pasojë e mos ndikimit nga trajtimi)
- Fëmijët janë bashkuar në dy grupe kryesore bazuar në zonën e banimit Qytet/Fshat. Brenda këtyre grupeve kryesore janë ndarë në grup moshat: parashkollorët deri 5 vjeç, 5-11 vjeç dhe > 11 vjeç
- Të gjithë fëmijëve pas vendosjes së diagnozës i është përcaktuar graviteti i astmës sipas GLOBAL STRATEGY FOR ASTHMA MANAGEMENT AND PREVENTION Revised 2006, dhe GUIDLINE FOR THE DIAGNOSIS AND MANAGEMENT OF ASTHMA Full Report 2007 National Asthma Education and Prevention Program

National Heart, Lung and Blood Institute (Shih tabelat ne aneksin bashkangjitur ne fund).

- Të gjithë fëmijëve pas përcaktimit të gravitetit në përputhje më të i është filluar mjekimi për kontrollin e astmës sipas GLOBAL STRATEGY FOR ASTHMA MANAGEMENT AND PREVENTION Revised 2006, dhe GUIDLINE FOR THE DIAGNOSIS AND MANAGEMENT OF ASTHMA Full Report 2007 National Asthma Education and Prevention Program National Heart, Lung and Blood Institute (Shih tabelat bashkangjitur ne fund). Skema e mjekimit ka qenë e njëjtë për të dy grupet në varësi të gravitetit të astmës. Barnat e përdorur për mjekim mbajtës kanë qenë: Antileukotrienet (montelukast), kortikosteroid inhalator (beclomethasone dipropionate, Fluticasone propionate),  $\beta_2$  agonsit me veprim të gjatë (salmeterol) si terapi shtesë për kortikosteroid inhalator.
- Pas fillimit të mjekimit për kontrollin e astmës fëmijët janë rivlerësuar në dinamikë për kontrollin apo jo të sëmundjes bazuar sipas GLOBAL STRATEGY FOR ASTHMA MANAGEMENT AND PREVENTION Revised 2006, dhe GUIDLINE FOR THE DIAGNOSIS AND MANAGEMENT OF ASTHMA Full Report 2007 National asthma education and prevention program National Heart, Lung and blood institute (Shih tabelat në aneksin bashkangjitur në fund). Për efekt studimi të gjithë fëmijët e të dy grupeve janë vlerësuar pas një viti të trajtimit për gjendjen e kontrollit të astmës
- Për çdo pacient të futur në studim është hartuar një pyetësor për të dhënat e përdorura për studim. Pyetësi është plotësuar nga doktoranti. Para plotësimit është marrë pëlqimi i prindit për pjesëmarrje në studim dhe fletëmiratimi i nënshkruar nga prindi i fëmijës. Të dhënat janë marrë nga prindi respektivisht kujdestari i fëmijës .(Shih pyetësin bashkangjitur në fund)
- Fëmijë të zonave urbane janë konsideruar fëmijët nga zonat e urbanizuar gjeografikisht të paracaktuara në varësi të nivelit të vendbanimit që karakterizohet nga densiteti më i madh i popullësisë
- Ushqyerje me gji është konsideruar ajo ekskluzivisht me gji 4 muajt e parë të jetës, ushqyerje me formula apo qumësht lope, kur ato janë përdorur para 4 muajve të parë të jetës.
- Madhësia e familjes është klasifikuar : 5 anëtarë, 5-10 anëtarë dhe mbi 10 anëtarë dhe radha e fëmijëve përkatësisht: i vetëm, fëmijë i parë fëmijë i dytë etj.
- Anamnezë personale pozitive për atopi është konsideruar prania te fëmija i dermatitit atopik, rinitit atopik apo alergjive të tjera te vërtetuara nga mjeku.
- Anamneza familjare për atopi pozitive është konsideruar nëse një anëtar i breznisë së parë (nëna, babai, vëllai, motra), kanë patur alergji të vërtetuar nga mjeku

- Ekspozimi ndaj tymit të duhanit është quajtur i pranishëm edhe kur vetëm një anëtar i familjes pi duhan në shtëpi
- Peshë dhe gjatësia janë shënuar në momentin e plotësimit të pyetësorit. Nga këto matje është kalkuluar body mass index (BMI) e bazuar në formulën  $[BMI = \text{weight (kg)}/\text{height (m)}^2]$ . [BMI = weight (kg)/height (m)<sup>2</sup>], vlerat janë hedhur në tabelën e percentileve duke klasifikuar fëmijën mbi peshë për BMI në percentilin 85-90 dhe obez për percentilin 95 e sipër.
- Prania e lagështisë në ambientin ku jeton fëmija është konsideruar pozitiv kur prindët kanë pohuar se kanë prani të mykut në muret e shtëpisë.
- Kontakti i nënës me kafshë shtëpiake është quajtur i pranishëm kur nëna gjatë shtatzënësisë ka patur kontakt të rregullt, të paktën një herë në javë ( bazuar në pyetësorin ISSAC) me kafshët që mbajnë në fshatra (gjethe, derr, dele, dhi, shpende, qen, mace).
- Kontakti i fëmijës me kafshë shtëpiake është quajtur i pranishëm kur fëmija ka patur kontakt të rregullt, të paktën një herë në javë ( bazuar në pyetësorin ISSAC) me kafshët që mbajnë në fshatra (gjethe, derr, dele, dhi, shpende, qen ,mace).

## 2. Metoda statistikore

Të gjitha të dhënat e mbledhura u hodhën në kompjuter në programin Microsoft-Excel, nga ku më pas u eksportuan në SPSS (*Statistical Package for Social Sciences*) 20.0, program në të cilin u realizua e gjithë analiza statistikore.

Proçedurat dhe teknikat statistikore të aplikuara në analizën e të dhënave të këtij studimi përshkruhen me hollësi më poshtë:

- Për të gjitha variablet (ndryshorët) kategorike (*nominale* përfshi shkallën *binare/dikotomike* dhe *ordinale*), u llogaritën numrat absolute dhe përqindjet përkatëse.
- Për të gjitha variablet *numerike* kur të dhënat që i nënshtroheshin shpërndarjes normale, u llogaritën mesataret *aritmetike*  $\pm$  *deviacionet standarte* përkatëse.
- Për të dhënat parametrike dhe jo parametrike (*ordinale*) u llogaritën koeficientët e korrelacionit *Pearson* dhe *Kendal's tau*.
- Diferencat mes grupeve për variabla diskrete, u analizuan me anë të testit Hi-katror.
- Paraqitja e të dhënave u krye me anë të tabelave të thjeshta dhe të përbëra, si dhe përmes grafikëve të tipit, bar-diagramë, diagram me sipërfaqe, etj.
- U konsideruan sinjifikante vlerat e  $p \leq 0.05$

Analiza korelative ndërmjet parametrave të ndryshëm për një apo më shumë veçori, paraqet bashkëlidhjen korelative të dy variablave të pavaruara . Ky tregues shërben indirekt për të vlerësuar vlerën specifike në procese të ndryshme . Nga ky këndvështrim me rëndësi të vacantë është përcaktimi i koeficientit të korelacionit si vlerë praktike e një fenomeni pavarësisht se është pozitive apo negative kushtëzimi i veçorisë. Fuqia apo lidhja korelative e koeficientit të llogaritur për parametrat e hulumtuar është vlerësuar sipas klasifikimit Romer–Orphalov. Kurse përshkrimi dhe interpretimi i të dhënave të cilat ishin në hulumtim janë bërë sipas metodës standarde për këtë natyrë të punës. Programi cili është përdorur për përpunim të të dhënave ishte MINITAB-17. Detajet janë të dhëna në tabelën në vijim.

#### Koeficienti i korelacionit

<b>Koeficienti (r)</b>	<b>Tipi i lidhjes</b>
0.0-0.1	Nuk ka korelacion <sup>N.S</sup>
0.1-0.25	Korelacion shumë I dobët <sup>N.S</sup>
0.25-0.4	I dobët*
0.4-0.5	I mesëm*
0.5-0.75	I forte**
0.75-0.9	Shumë I forte**
0.9-1	Plotësishtë korelative**

## KAPITULLI IV: REZULTATET DHE DISKUTIMI

### 1. Vlerësimi i prevalencës, gravitetit dhe kontrollit të astmës në dy grupet e marra në studim.

#### 1.1. Vlerësimi i prevalencës dhe gravitetit në dy grupet urbane dhe rurale

Janë studiuar 178 fëmijë me astmë persistente të diagnostikuar, mjekuar dhe ndjekur në Qendrën Klinike Universitare të Prishtinës, nga të cilët 101 fëmijë (56,7%) me banim në zonë urbane dhe 77 fëmijë (43,25%) me banim në zonë rurale me grup moshat sikurse janë paraqitur në tabelën 1. Sikurse shihet nga tabela në grupet e marra në studim nuk ka ndryshim të rëndësishëm midis dy grupeve në drejtim të prevalencës së astmës, pra grupet janë statistikisht të barabarta. Në përzgjedhjen fillestare kanë qënë edhe 71 fëmijë me astmë intermitente të cilët nuk u vunë në mjekim mbajtës. Këta fëmijë janë ndjekur në shërbimin parësor duke u mjekuar me bronkodilatatorë me veprim të shkurtër sipas nevojës. Këta fëmijë nëse gjatë viteve të studimit kanë patur ndryshim të shkallës së astmës janë futur në studim duke bërë pjesë në numrin total të fëmijëve me astmë të paraqitur për studim.

Tabela 1: Fëmijët e marrë në studim sipas grup moshave

Moshë	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
≤ 5 vjeç	24 23.80%	17 22.10%	41 23.00%	16.9 - 29.2	0.958
5- 11 vjeç	57 56.40%	45 58.40%	102 57.30%	50.0- 64.0	
>11 vjeç	20 19.80%	15 19.50%	35 19.70%	14- 25.8	

Në studimin tonë moshat e fëmijëve e analizuar në bazë të vendbanimit (tabela 1), zona urbane apo rurale, nuk tregojnë dallim të rëndësishëm. Grup moshë që më shumë na paraqitet në studim është 5-11 vjeç për të dy grupet tona me dallim jo të rëndësishëm prej 56.40% në zonat urbane dhe 58.40% në zonat rurale, po ashtu nuk kemi dallim edhe në grup moshat e tjera midis fëmijëve të zonave urbane dhe rurale, deri 5 vjeç dhe mbi 11 vjeç (p 0.958).


Prevalenca e astmës ndryshon në vende të ndryshme të botës por sipas ISSAC faza e parë dhe tretë, kemi rritje më të madhe të prevalencës në vendet që kanë pasur prevalencë

më të ulët. Në Shqipëri rezultatet nuk tregojnë rritje të prevalencës së astmës mes 2 fazave të ISAAC (111). Punimet e autorëve të ndryshëm tregojnë rezultate të ndryshme kështu punime të bëra në Arkansas dhe Chile nuk tregojnë ndryshime në prevalencën e astmës tek fëmijët e zonave urbane krahasuar me fëmijët e zonave rurale (7, 112); ndërkohë që punime të tjera në Austri, Kinë dhe Egjipt, studimi në Evropën veriore flasin për risk më të lartë të astmës te fëmijët e zonave urbane (113,114,115,116,117).por nuk dihet cili proces i urbanizimit është përgjegjës(118)

Tabela 2. Përcaktimi i gravitetit të astmës para fillimit të mjekimit te fëmijët në studim

Graviteti i astmës para terapis	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
persistent i lehtë	89 88.10%	59 76.60%	148 83.10%	78.2- 89.1	0.091
persistent i moderuar	12 11.90%	17 22.10%	29 16.30%	10.9- 21.8	
persistent i rëndë	0 0.00%	1 1.30%	1 0.60%		

Grafiku1. Graviteti i astmës para fillimit të mjekimit te fëmijët në studim



Para fillimit të mjekimit është përcaktuar graviteti i astmës (Tabela 2, Grafiku 1), 148 (83.10%) fëmijë janë vlerësuar si astmë perzistente e lehtë, 29 (16.30%) fëmijë si astmë perzistente e moderuar dhe 1 (0.60%) fëmijë astmë perzistente e rëndë. Ndër fëmijët nga zonat urbane, 89 (88.10%) janë me astmë perzistente të lehtë, 12 (11.90%) me astmë perzistente të moderuar dhe



asnjë fëmijë nuk paraqet astmë persistente të rëndë. Ndër fëmijët nga zonat rurale, 59 (76.60%) janë me astmë persistente të lehtë, 17 (22.10%) me astmë persistente të moderuar dhe vetëm 1(1.30%) fëmijë është me astmë perzistente të rëndë. Ndryshimet midis grupeve nuk janë të rëndësishme (p 0.091).

Përcaktimi i gravitetit të astmës para fillimit të mjekimit mbajtës nuk tregon dallime të rëndësishme në gravitetin e astmës, midis dy zonave urbane dhe rurale, ndonëse, astma persistente e lehtë tregon një prevalencë disi më të lartë në zonat urbane krahasuar me ato rurale, ndërkohë që në zonat rurale kemi prevalencë më të lartë të astmës persistente të moderuar dhe të rëndë. Bazuar në të dhëna të literaturës, punime të bëra në vende të ndryshme tregojnë rezultate të ndryshme. Kështu punime të bëra në Austri, disa qytet në SHBA (113,119) nuk tregojnë ndryshime të rëndësishme statistikore në gravitetin e astmës mes zonave urbane dhe rurale, ndërkohë që në një punim tjetër të bërë në Arkanzas ky ndryshim është sinjifikant (7). Të dhënat e hulumtimit ISSAC në Shqipëri nuk tregojnë për forma më të rënda të astmës mes dy fazave të hulumtimit (111)

Tabela 3. Graviteti i astmës pas 12 muaj të përcjelljes së fëmijëve

Graviteti pas përcjelljes 12 muaj	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Intermitente	20 19.80%	15 19.70%	35 19.80%	21.1- 24.2	0.971
perz e lehtë	74 73.30%	55 72.40%	129 72.90%	69.7- 83.0	
e moderuar	7 6.90%	6 7.90%	13 7.30%	2.4- 9.1	


Pas përcjelljes 12 mujore të terapis është rivlerësuar graviteti i astmës (Tabela 3). Kështu 35(19.80%) fëmijë janë vlerësuar si astmë intermitente, 129(72.90%) fëmijë si astmë perzistente e lehtë dhe 13 (7.30%) fëmijë astmë perzistente e moderuar. Në zonat urbane, 20(19.80%) fëmijë janë me astmë intermitente, 74 (73.30%) me astmë persistente të lehtë dhe 7 (6.90%) me astmë persistente të moderuar. Në zonat rurale, 15 (19.70%) fëmijë janë me astmë intermitente, 55 (72.40%) me astmë persistente të lehtë dhe 6 (7.90%) me astmë perzistente të moderuar. Ky rezultat nuk është sinjifikant(p 0.097)

Në tabelën 4 dhe grafikun 2 janë paraqitur përqindja e fëmijëve të cilët kanë ndryshuar gravitetin e astmës pas 12 muaj të përcjelljes. Me gravitet të ulur të astmës janë 4% e fëmijëve nga fshati dhe 5.30% e fëmijëve nga qyteti, graviteti i astmës i njëjtë është te 67.30% të fëmijëve nga fshati dhe 56.60% të fëmijëve të qytetit dhe fëmijë me gravitet të përmysuar janë 28.70% e fëmijëve të fshatit dhe 38.20% e fëmijëve të qytetit.

Tabela 4. Përqindja e përmisimit të gravitetit të astmës pas 12 muaj të mjekimit

	grav astmës i ulur	grav astmës njejtë	grav astmës përmis
fshat	4.00%	67.30%	28.70%
qytet	5.30%	56.60%	38.20%

Grafiku 2. Përqindja e përmisimit të gravitetit të astmës pas 12 muaj të mjekimit



Graviteti i astmës pas 12 muaj nuk tregon dallime statistikisht të rëndësishme pas 12 muaj përcjellje si te fëmijët e fshatit ashtu edhe të qytetit por një përqindje më e lartë e fëmijëve nga qyteti kanë treguar ndryshim të gravitetit në kuptim të përmisimit të gravitetit të astmës 38.20% vs 28.70%.


## 1.2. Vlerësimi i kontrollit të astmës ne dy grupet urbane dhe rurale

Rivlerësimi pas 1 viti të fëmijëve të përfshirë në studim për gjendjen e kontrollit të astmës së tyre tregoi se nuk kemi ndryshim të rëndësishëm statistikisht mes fëmijëve të zonave urbane dhe rurale sa i përket kontrollit të astmës (shih Tabelen 5). Tërheq vëmendjen fakti se niveli i kontrollit të astmës është mjaft i lartë që tregon se me gjithë vështirësitë ekonomike, ato të lidhura me sigurimin e barnave prindët janë të ndjeshëm ndaj astmës së fëmijëve dhe kanë mjekuar fëmijët jo vetëm në zonat urbane por edhe ato rurale. Vlen të shënohet gjithashtu se kontrolli i mirë i astmës lidhet edhe me faktin se shumica e fëmijëve të studiuar paraqesin astmë persistente të butë.

Tabela 5. Vlerësimi i kontrollit të astmës së fëmijëve pas 12 muaj mjekimi

Kontrolli i astmës pas 12 muaj	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
e kontrolluar	97 96.00%	70 90.90%	167 93.80%	12.124.2	0.192
pjesërisht e kontrolluar	4 4.00%	5 6.50%	9 5.10%	69.7- 83.0	
e pakontrolluar	0 0.00%	2 2.60%	2 1.10%	2.4- 9.1	

Grafiku 3. Kontrolli i astmës pas 12 muaj të mjekimit të fëmijëve



*Pas 12 muaj të përcjelljes së fëmijëve është vlerësuar kontrolli i astmës (Tabela 5, Grafiku 3): Në 167 (93.80%) fëmijë astma është vlerësuar e kontrolluar, në 9 (5.10%) fëmijë astma është pjesërisht e kontrolluar dhe në 2 (1.10%) fëmijë astma nuk është e kontrolluar. Në zonat urbane, në 97 (96.00%) fëmijë është vlerësuar se astma është e kontrolluar, në 4 (4.00%) fëmijë, astma është pjesërisht e kontrolluar dhe në asnjë fëmijë nuk është vlerësuar se nuk është e kontrolluar. Në zonat rurale, në 70 (90.90%) fëmijë astma është vlerësuar e kontrolluar, në 5 (6.50%) fëmijë pjesërisht e kontrolluar dhe në 2 (2.60%) fëmijë astma nuk është e kontrolluar. Midis grupeve ndryshimi nuk është i rëndësishëm (p 0.192)*

## 2.0. Vlerësimi i faktorëve të rrezikut paralindjes

### 2.1. Vlerësimi i ndikimit të historisë familjare për atopi.

Duke u munduar të shikojmë ndikimin e historisë familjare pozitive për atopi në këto dy grupe kryesore (urbane dhe rurale) (tabelat 6,7, 8 dhe Grafiku 4) rezulton se, prania e atopisë te nënat e fëmijëve nga zonat urbane është më e lartë se te nënat e fëmijëve nga zonat rurale por ky ndryshim nuk është statistikisht i rëndësishëm. Poashtu prania e atopisë te baballarët tregojnë vlera statistikisht jo të rëndësishme, ndërkohë që prania e atopisë në motrat e vëllezërit e fëmijëve me astmë nga zonat urbane ndryshon në mënyrë të rëndësishme duke qenë më e lartë se në fëmijët e zonave urbane.

Tabela 6. Prania e historisë për atopi te nëna e fëmijës me astmë

	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Nëna alergji					
Po	11 10.90%	3 3.90%	14 7.90%	3.6- 12.1	0.073
Jo	90 89.10%	74 96.10%	164 92.10%	87.9- 96.4	

*Nëna të fëmijëve me astmë me të dhëna për atopi janë 14 (7.90%) ndërkohë që 164 (92.10%) nuk kanë të dhëna. Në zonat urbane nëna me të dhëna për atopi janë 11(10.90%) dhe 90 (89.10%) pa të dhëna për atopi .Në zonat rurale nëna me të dhëna për atopi janë 3 (3.90%) dhe 74 (96.10%) pa të dhëna. Ky rezultat statistikisht nuk është i rëndësishëm(p 0.073)*

Tabela 7. Prania e historisë për atopi te babai i fëmijës me astmë

	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Baba alergji					
Po	8 7.90%	4 5.20%	12 6.70%	3.0- 10.9	0.343
Jo	93 92.10%	73 94.80%	166 93.30%	89.1- 97.0	


Numri i baballarëve me histori për atopi është 12 (6.70%) dhe pa të dhëna për atopi 166 (93.30%). Në zonat urbane historia për atopi është e pranishme në 8 (7.90%) raste kundrejt 93 (92.10%) rasteve pa të dhëna. Baballarët e fëmijëve nga zonat rurale që kanë alergji janë 4 (5.20%) dhe 73 (94.80%) nuk kanë alergji. Ky rezultat statistikisht nuk është i rëndësishëm (p 0.343)

Tabela 8: Prania e fëmijëve të tjerë në familje me atopi

Vëllau motra (sibling)	vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Po	11 10.90%	1 1.30%	12 6.70%	3.0- 97	0.009
Jo	90 89.10%	76 98.70%	166 93.30%	90.3- 97.0	

Fëmijët nga të cilët vëllau/motra kanë alergji janë gjithsej 12 (6.70%) fëmijë dhe fëmijë që nuk raportohet se vëllau/motra kanë alergji janë 76 (98.70%) fëmijë. Fëmijët që vijnë nga zonat urbane dhe kanë vëlla/motër me alergji janë 11(10.90%) fëmijë dhe vëlla /motër që nuk ka alergji janë 90 (89.1%) fëmijë. Fëmijët që vijn nga zonat rurale dhe kanë vëlla/motër me alergji është 1 (1.30%) fëmijë dhe fëmijë ku vëlla/motër nuk ka alergji janë 76 (98.70%) fëmijë. Ky rezultat statistikisht është i rëndësishëm ( p 0.009)

Grafiku 4. Anëtarët e familjes të fëmijës me astmë me histori pozitive për atopi



Sipas literaurës prania e atopis te prindërit dhe fëmijët tjerë rritë prevalencën e alergjisë (120,121,122,123,124) por bazuar në të dhënat e mësipërme(Grafiku 4) mund të themi se ka një ndryshim të rëndësishëm në prevalencën e astmës që është më e lartë në fëmijët e zonave urbane që kanë tashmë një sibling me histori për atopi, ndërkohë që historia pozitive për atopi te prindët nuk duket të ndikojë në mënyrë të rëndësishme në prevalencën e astmës në zonat urbane ose rurale . Kjo e dhënë ndoshta lidhet më tepër me kushtet e jetesës së fëmijëve të një familje më tepër se sa me faktorë të lidhur me gjenetikën familjare. Kështu një analizë e fundit e të dhënave të studimit ISAAC krahason të dhënat e prevalencës së Astmës në fëmijët kinezë që jetojnë në Vancouver, Kanada me ata që jetojnë në Kinë duke treguar ndryshime të rëndësishme të prevalencës së astmës në këta fëmijë gjenetikiisht të ngjashëm, por që jetojnë në ambiente të ndryshme. Kështu prevalenca e astmës në fëmijët 13-14 vjeç ishte më e ulët në ata që kishin lindur dhe jetonin në Kinë, krahasuar me fëmijët kinezë që kishin migruar në Kanada apo që kishin lindur dhe jetonin në Kanada, duke qenë një tregues i rëndësishëm i ndikimit të ambientit dhe mënyrës së jetesës. (8)

## 2.2.Vlerësimi i ndikimi të pirjes së duhanit nga nëna gjatë shtatzënisë

Tabela 9. Pirja e duhanit nga nëna e fëmijës me astmë gjatë shtatzënisë

Duhan	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Po	25 24.80%	11 14.30%	36 20.20%	14.6- 26.4	0.061
Jo	76 75.20%	66 85.70%	142 79.80%	73.6- 85.4	

*Në punimin tonë gjatë shtatzënisë 36 (20.20%) nëna kanë konsumuar duhan (Tabela 9) dhe 142 (79.80%) nëna nuk kanë konsumuar duhan. Nënave e fëmijëve nga zonat urbane që kanë përdorur duhan janë 25 (24.80%) nëna ndërsa nuk kanë përdorur duhan gjatë shtatzënisë 76 (85.70%) të nënave. Nënave e fëmijëve nga zonat rurale të cilat nuk kanë përdorur duhan janë 11 (13.40%) ndërsa nëna që kanë përdorur duhan janë 66 (85.70%) nëna. Ky rezultat statistikisht nuk është i rëndësishëm (p 0.061)*

Dihet rëndësia e pirjes së duhanit si gjatë shtatzënisë edhe më pas dhe ndikimi i tij në astmën e fëmijës (125,126,127,128,129,130) Në punimin tonë vërehet se numri i nënave të fëmijëve nga zonat urbane që kanë pirë duhan gjatë shtatzënisë është më i lartë krahasuar me nënat e fëmijëve nga zonat rurale, respektivisht 24,80% dhe 20,20% e

lidhur kjo ndoshta me sjelljen më tradicionale në fshat, sidoqoftë ky ndryshim nuk është i rëndësishëm nga ana statistikore

### 2.3. Vlerësimi i ndikimit të përdorimit të antibiotikëve nga nëna gjatë shtatzënisë

Për sa i përket përdorimit të antibiotikëve nga nëna gjatë shtatzënisë, duke ju referuar literaturës ka të dhëna që flasin për një rrezikshmëri më të madhe për të zhvilluar astmë në fëmijët e këtyre nënave sidomos në fëmijërinë e hershme.(131). Ky rrezik është gjetur më i lartë në femijët e vegjël se te ata më të rritur. (25) .Sipas disa punimeve edhe fëmijet e nënave që para shtatzënisë kanë përdorur antibiotikë, kanë patur më shumë dermatit, fishkëllima dhe astmë(132,133)por edhe e lidhur me predispozita familjare(134)

Tabela 10. Përdorimi i antibiotikëve nga nëna e fëmijës me astmë gjatë shtatzënisë

Moshë e fëmijëve			Vendbanimi			Vlera e Hi-katrorit	Vlera p
			Qytet	Fshat	Total		
deri 5 vjeç	Antibiotik shtatzëni	po	12	11	23	.874 <sup>a</sup>	0.270
			50.00%	64.70%	56.10%		
		jo	12	6	18		
			50.00%	35.30%	43.90%		
	Total		24	17	41		
		100.00%	100.00%	100.00%			
mbi 5 vjeç	Antibiotik shtatzëni	po	35	24	59	.409 <sup>c</sup>	0.321
			45.50%	40.00%	43.10%		
		jo	42	36	78		
			54.50%	60.00%	56.90%		
	Total		77	60	137		
		100.00%	100.00%	100.00%			

*Në zonat urbane në fëmijët deri 5 vjeç nënat e të cilëve kanë përdorur antibiotikë gjatë shtatzënisë janë 12 (50.00%) dhe 12 (50.00%) fëmijë nënat e të cilëve nuk kanë përdorur antibiotik. Në zonat rurale fëmijët ku nënat kanë përdorur antibiotik janë 11 (64.70%) kundrejt 6 (35.30%) fëmijëve ,nënat e të cilëve nuk kanë përdorur. Për fëmijët mbi 5 vjeç nga zonat urbane kur nëna ka përdorur antibiotik gjatë shtatzënisë janë 35 (45.50%) fëmijë, dhe ku nuk ka përdorur antibiotik janë 42 (54.50%) fëmijë; ndërsa nga zona rurale fëmijët ku nëna ka përdorur antibiotik gjatë shtatzënisë*

janë 24 (40.00%) fëmijë dhe ku nëna nuk ka përdorur antibiotik janë 36 (60.00%) fëmijë. Ky rezultat statistikisht nuk është i rëndësishëm te asnjëra grupmoshë (p 0.270 dhe p 0.321)

Bazuar në rezultatet tona (shih tabelën 10), nuk vërehet ndonjë ndryshim statistikisht i rëndësishëm qoftë në grup moshën e fëmijërisë së hershme <5 vjeç qoftë më vonë në të dy grupet e fëmijëve nga zonat urbane ose rurale edhe pse antibiotikët janë përdorur në mënyrë të konsiderueshme, respektivisht në 45,5% dhe 40.0 %.

#### 2.4. Vlerësimi i kontaktit të nënës me kafshë shtëpiake gjatë shtatzënisë

Tabela 11: Kontakti me kafshë i nënës së fëmijës me astmë gjatë shtatzënisë

Kontakt me kafshë	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Po	14 13.90%	31 40.30%	45 25.30%	19.1- 32.0	<0.001
Jo	87 86.10%	46 59.70%	133 74.70%	68.0- 80.9	

Gjatë shtatzënisë 45 (25.30%) nëna kanë pasur kontakt direkt me kafshë dhe 133 (74.70%) nëna nuk kanë pas kontakt me kafshë. Nënmat me vendbanim në zonat urbane , 14 (13.90%) nëna kanë pas kontakt me kafshë dhe 87 (86.10%) nëna nuk kanë pas kontakt me kafshë. Nënmat që jetojnë në zona rurale, 31 (40.30%) nëna kanë pas kontakt me kafshë dhe 46 (59.70%) nëna nuk kanë pas kontakt me kafshë(tabela 11).Kemi rezultat statistikisht të rëndësishëm (p <0.001)

Vlen të shënohet se rezulton i rëndësishëm fakti që kontakti me kafshë i nënave gjatë shtatzënisë shoqërohet me një prevalencë më të lartë të astmës në fëmijët nga zonat rurale krahasuar me ata nga zonat urbane, respektivisht 40,30% dhe 13.9%. Po ashtu të dhënat e studimit ISSAC faza 3-të (27) apo studime të tjera të kryera në Finlandë dhe Rusi (135) kanë treguar se kontakti i nënave me kafshë shtëpiake gjatë shtatzënisë shoqërohet me më shumë simptoma të astmës te fëmijët.



## 2.5. Vlerësimi i ndikimit të peshës në lindje dhe mënyrës së lindjes

Tabela12: Pesha në lindje e fëmijëve të marrë në studim(urban/rural)

			Vendbanimi			Vlera e Hi-katrorit	Vlera p			
			Qytet	fshat						
deri 5 vjeç	Pesha lindjes	< 2500 gr	2 8.30%	2 11.80%	4 9.80%	.133 <sup>a</sup>	0.555			
		>= 2500 gr	22 91.70%	15 88.20%	37 90.20%					
		Total			24 100.00%			17 100.00%	41 100.00%	
	mbi 5 vjeç	Pesha lindjes	< 2500 gr	4 5.20%	5 8.30%			9 6.60%	0.541	0.346
			>= 2500 gr	73 94.80%	55 91.70%			128 93.40%		
Total			77 100.00%	60 100.00%	137 100.00%					

Fëmijë deri 5 vjeç të lindur me peshë të lindjes nën 2500gr janë 2 (8.30%) fëmijë dhe mbi 2500 gr janë 22 (91.70%) fëmijë nga qyteti ndërsa nga fshati nën 2500 gr janë 2(11.80%) fëmijë dhe mbi 2500 gr janë 15 (88.20%) fëmijë. Fëmijë mbi 5 vjeç të lindur me peshë të lindjes nën 2500 gr janë 4(5.20%) fëmijë dhe mbi 2500 gr janë 73 (94.80%) fëmijë nga qyteti ndërsa nga fshati të lindur me peshë të lindjes nën 2500 gr janë 5 (8.30%) fëmijë dhe me peshë mbi 2500 gr janë 55(91.70%)fëmijë. Ky rezultat statistiki nuk është i rëndësishëm (p 0.555 dhe p 0.346)

Për sa i përket peshës në lindje (shih tabelen 12), na rezultojnë se për peshën në lindje qoftë në total qoftë sipas grup moshave, nuk u vu re ndryshim i rëndësishëm për sa përket prevalencës së astmës midis dy zonave të marra në studim. Bazuar në të dhënat e literaturës pesha e vogël në lindje shoqërohet me një rrezik më të shtuar për fishkëllima të përsëritura sidoqoftë evidencat janë të dobëta dhe nevojiten studime të mëtejshme për të saktësuar lidhjen e peshës në lindje me astmën e fëmijëve. (136,137,138,139,140,141) .

Tabela13: Mënyra e lindjes së fëmijëve të marrë në studim (urban/rural)

mosha_new			Vendbanimi			Vlera e Hi-katrorit	Vlera p
			Qytet	Fshat	Total		
deri 5 vjeç	Mënyra lindjes	normale	17	10	27	.638 <sup>a</sup>	0.32
			70.80%	58.80%	65.90%		
		sectio	7	7	14		
			29.20%	41.20%	34.10%		
	Total		24	17	41		
			100.00%	100.00%	100.00%		
mbi 5 vjeç	Mënyra lindjes	normale	60	56	116	6.171 <sup>c</sup>	0.011
			77.90%	93.30%	84.70%		
		sectio	17	4	21		
			22.10%	6.70%	15.30%		
	Total		77	60	137		
			100.00%	100.00%	100.00%		

Fëmijë deri 5 vjeç nga zonat urbane të lindur me rrugë normale janë 17 (70.80%) fëmijë dhe me Sectio Cesarea janë 7 (29.20%) fëmijë; ndërsa nga zonat rurale janë 10 (58.80%) fëmijë të lindur me rrugë normale dhe 14 (34.10%) fëmijë janë të lindur me Sectio Cesarea. Fëmijë mbi 5 vjeç nga zonat urbane të lindur me rrugë normale janë 60 (77.90%) fëmijë dhe 17 (22.10%) fëmijë janë lindur me Sectio Cesarea; ndërsa nga zonat rurale 56 (93.30%) fëmijë janë lindur me rrugë normale dhe 4 (6.70%) fëmijë janë lindur me Sectio Cesarea. Ky rezultat është statistikisht jo i rëndësishëm për moshën deri 5 vjeç (p 0.32) dhe statistikisht i rëndësishëm për moshën mbi 5 vjeç (p 0.011)

Për sa i përket mënyrës së lindjes ( shih tabelen 13), vërehet për grupin e fëmijëve mbi 5 vjeç, se prevalenca e astmës është me e madhe në mënyrë të rëndësishme në fëmijët e lindur me Sectio Cesarea (SC) në fëmijët nga zonat urbane krahasuar me grupin e fëmijëve nga zonat rurale. Studimet në drejtim të lidhjes midis mënyrës së lindjes nëpërmjet Sectio Cesarea dhe astmës e alergjisë kanë treguar gjetje kontradiktore. Disa studime tregojnë se fëmijët e lindur me SC kanë një rrezik më të shtuar për astmë sidomos te familjet që kanë atopi (142,143,144), sidoqoftë të dhënat janë të kufizuara dhe shpesh kontradiktore (145)

### 3.0. Vlerësimi i faktorëve të rrezikut në fëmijëri

#### 3.1. Vlerësimi i ndikimit të moshës së fillimit të simptomave

Ne 2008, European Respiratory Society Task Forc propozoi një klasifikim të ri për fëmijet e vegjël që zhvillojnë fishkëllima të përsëritura që i ndante ato në “episodic (viral) wheeze” dhe “multi-trigger wheeze”, klasifikim ky i bazuar në të dhënat e publikimeve shkencore dhe në opinionin e ekspertëve. Si përfundim pranohet nga të gjithë se fishkëllimat në moshën parashkollore që janë të shpeshta dhe të rënda dhe sidomos kur shoqërohen me atopi, kanë më shumë mundësi që të perzistojë përgjatë fëmijërisë dhe në moshën e adultit. (146,147,148,149). Në studimin tonë kemi krahasuar moshën e fillimit të fishkëllimave në dy grupet e fëmijëve nga zonat rurale dhe urbane, por ndyshimi nuk është i rëndësishëm qoftë në total, qoftë në grup moshat kryesore (shih tabelën 14 )

Tabela 14. Paraqitja e kohës së shfaqjes së simptomave te fëmija me astmë

Koha e shfaqjes së simptomave	Total (n=178)	Vendbanimi	
		qytet (n=101)	fshat (n=77)
deri 3 vjeç	116 65.20%	67 66.30%	49 63.60%
3-7 vjeç	53 29.80%	27 26.70%	26 33.80%
mbi 7 vjeç	9 5.10%	7 6.90%	2 2.60%

Hi katror =2.397,P= 0.30

*Fillimi i hershëm i simptomave para moshës 3 vjeçare (Tabela14) ka qenë te 116(65.20%) fëmijë,fillimi i ndërmjetëm prej 3-7 vjeç ka qenë te 53(29.80%) fëmijë dhe fillim i vonshëm ka qenë te 9(5.10%) fëmijë.Fëmijë nga zonat urbane me fillim të hershëm kanë qenë 67 (66.30%) fëmijë,me fillim të ndërmjetëm 27 (26.70%) fëmijë dhe me fillim të vonshëm 7 (6.90%) fëmijë.Fëmijë nga zonat rurale me fillim të hershëm të simptomave kanë qenë 49 (63.60%) fëmijë,me fillim të ndërmjetëm 26 (33.80%) fëmijë dhe me fillim të vonshëm 2 (2.60%) fëmijë.Ky rezultat statistikisht nuk është i rëndësishëm(p 0.30)*

### 3.2. Vlerësimi i ndikimi të ushqyerjes me gji

Efekti mbrojtësi ushqyerjes me gji ndaj astmës dhe alergjisë, mbetet shumë i diskutueshëm edhe pse, mendohet që ushqyerja me gji mbron fëmijën nga astma dhe alergjia. Astma është një sindrom heterogjen që përfshin shumë fenotipe të veçanta secili me mekanizmin e tij fizopatogjenetik dhe faktorët e tij të rrezikut. Ushqyerja me gji mund të shërbejë si një faktor mbrojtës për çdo fenotip nëpërmjet mekanizmave të ndryshëm që ndikojnë në infeksionet respiratore dhe /ose duke nxitur sistemin imunitar. Efekti mbrojtës i ushqyerjes me gji, krahasuar me atë të përzierë apo me formulë është bazuar në të dhënat e studimeve, ndonëse, mbetet ende i papërcaktuar qartë (150,151,152,153,154)

Tabela 15. Mënyra e ushqyerjes së fëmijëve të marrë në studim(urban/rural)


ne gji/ form/ qum lope	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
<4 muaj	4	0	4	0.6- 4.8	0.031
	4.00%	0.00%	2.20%		
>4 muaj	80	52	132	66.1- 79.4	
	79.20%	67.50%	74.20%		
formulë	15	20	35	14.5- 27.3	
qumësht lope	2	5	7	1.2- 7.3	
	2.00%	6.50%	3.90%		

Fëmijëve të ushqyer ekskluzivisht me gji nën 4 muajt e parë të jetës (tabela 15, grafiku 5) kanë qenë 4(2.20%) fëmijë, ndërsa 132 (74.20%) fëmijë janë ushqyer më gjatë se 4 muaj në gji. Me formulë janë ushqyer 35 (19.70%) fëmijë dhe me qumësht lope 7 (3.90%) fëmijë. Nga zonat urbane 4 (4.0%) fëmijë janë ushqyer më pak se 4 muaj me gji dhe 80 (79.20%) fëmijë janë ushqyer më gjatë se 4 muaj, 15 (14.90%) fëmijë janë ushqyer me formulë dhe 2 (2.00%) fëmijë me qumësht lope. Nga zonat rurale asnjë nuk është ushqyer më pak se 4 muaj me gji, 52 (67.50%) fëmijë janë ushqyer më gjatë se 4 muaj me gji, 20 (26.00%) fëmijë janë ushqyer me formulë dhe 5(6.50%) fëmijë me qumësht lope. Kemi dallim sinjifikant në mënyrën e ushqimit mes fëmijëve të zonave urbane (p 0.031).

Për sa i përket mënyrës së ushqyerjes në fëmijët e marrë në studim vërehet se si në zonat urbane dhe ato rurale predominon ushqyerja me gji për mbi 4 muaj, respektivisht 79,20%, në zonat urbane dhe 67,50 % në zonat rurale. Tërheq vëmendjen fakti që prevalencë e astmës është më e lartë në fëmijët e ushqyer me gji në zonat urbane krahasuar me ato rurale, fakt ky që, ndoshta lidhet me diagnostikimit më të mirë të astmës në zonat urbane.

Në grupin e fëmijëve të ushqyer me formula dhe qumësht lope vërehet një prevalencë më e madhe e astmës në zonat rurale krahasuar me ato urbane duke përbërë ndryshim të rëndësishëm.

Grafiku.5. Mënyra e ushqyerjes së fëmijëve në studim në 4 muaj e parë të jetës



Sidoqoftë ushqyerja me gji duhet këshilluar për të gjitha efektet e tjera mbrojtëse të tij në mirëritjen e fëmijës. Kështu rekomandimet e deritanishme janë nxitja e ushqyerjes me gji deri të paktën 4-6 muaj dhe fillimi i ushqimeve shtesë nga mosha 4-6 muaj. Studimi tonë tregon se Kosova ka një traditë të mirë të ushqyerjes me gji, 74% e fëmijëve të studimit tonë janë ushqyer me gji mbi 4 muaj.

### 3.3. Vlerësimi i ndikimit të strukturës familjare

#### 3.3.1. Vlerësimi i madhësisë së familjes së fëmijëve

Për sa i përket madhësisë së familjes dhe radhës së fëmijës të dhënat tona tregojnë se prevalence e astmës është më e lartë si në zonat urbane dhe ato rurale në familjet me 5 deri në 10 anëtarë, respektivisht 47.50% dhe 50% pa përbërë një ndryshim të rëndësishëm midis dy grupeve kryesore urbane dhe rurale me përjashtim të familjeve të vogla deri 5 anëtarë kur astma është më e shpeshtë në mënyrë të rëndësishme në zonat urbane krahasuar

me ato rurale (shih tabelën 16). Referuar të dhënave të literaturës, hipoteza origjinale e higjenës sugjeronte që pakësimi i numrit të anëtarëve të familjes dhe i ekspozimit ndaj infeksioneve të fëmijërisë ishin përgjegjës për rritjen e sëmundjeve atopike. Një sërë studimesh epidemiologjike dhe longitudinale u përpoqën të testojnë këtë hipotezë duke zhvilluar konceptin e lidhjes me ndyshimet në përgjigjen imunitare dhe në mekanizmat imunoregulluese. Prevalenca e astmës mund të jetë e ulur në familjet me shumë anëtarë. Aktualisht të dhënat e studimeve në lidhjen e astmës me familjet e mëdha raportojnë të dhëna kontradiktore pozitive dhe jo pozitive (155,156,157) Po ashtu në studimin tonë të dhënat janë kontradiktore dhe të lidhura ndoshta jo aq me madhësinë e familjes se me ndikimin e faktorëve të tjerë në zonat urbane.

Tabela16 :Struktura e familjes së fëmijëve të marrë në studim(urban/rural)

Anëtarët familje	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
deri 5	44 43.60%	18 23.40%	62 34.80%	29.1- 44.2	<0.001
deri 10	48 47.50%	41 53.20%	89 50.00%	42.4- 57.0	
mbi 10	9 8.90%	18 23.40%	27 15.20%	8.5- 18.8	

*Në studimin tonë 62 (34.80%) fëmijë kanë jetuar në familje me 5 anëtarë, 89 (50.00%) fëmijë kanë jetuar në familje deri 10 anëtarë dhe 27 (15.20%) fëmijë kanë jetuar në familje me mbi 10 anëtarë. Fëmijë që jetojnë në familje deri 5 anëtarë janë 44 (43.60%) nga vendet urbane dhe 18 (23.40%) fëmijë nga vendet rurale. Fëmijë që jetojnë në familje deri 10 anëtarë janë 48 (47.50%) nga vendet urbane dhe 41 (53.20%) nga vendet rurale. Familjet e mëdha kanë dominur tek fëmijët nga vendet rurale, sidomos familjet me mbi 10 anëtarë ku 18 (23.40%) fëmijë janë nga zonat rurale ndërsa 9 (8.90%) nga zonat. Ky rezultat është statistikisht i rëndësishëm(p 0.001)*

### 3.3.2. Vlerësimi i radhës së fëmijës me astmë në familje

Për sa i përket ndikimit të radhës së fëmijës në familje rezultatet nuk tregojnë ndryshime të rëndësishme në drejtim të prevalencës së astmës në dy grupet kryesore të studiuara (shih tabelen 17, grafiku 6). Hipoteza e higjenës sugjeron që fëmija më i madh mbron fëmijët e tjerë më të vegjël nga astma nëpërmjet ndikimit në sistemin e tyre imunitar ende të pa pjekur si pasojë e kontaktit me infeksionet respiratore. Kështu prevalenca e


astmës duhet të jetë e lidhur në mënyrë të kundërt me radhën e lindjes së fëmijës, fakt ky që jo gjithmonë është vërtetuar nga studimet (55, 155,156)

Tabela 17: Paraqitja e radhës së fëmijës me astmë në familje

Radha e fëmijës	vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
fëmijë i vetëm	8 7.90%	8 10.40%	16 9.00%	5.5- 14.5	0.437
fëmijë i parë	53 52.50%	33 42.90%	86 48.30%	41.2- 56.4	
jo fëmijë i parë	40 39.60%	36 46.80%	76 42.70%	33.9- 48.5	

Fëmijë të vetëm në familje (Tabela 17, Grafiku 6), kanë qenë 16 (9.00%), fëmijë të parë 86 (48.30%), dhe jo fëmijë i parë 76 (42.70%). Në zonat urbane 8 (7.90%) fëmijë janë të vetëm, 53 (52.50%) janë fëmijë të parë dhe 40 (39.60%) nuk janë fëmijë të parë. Në zonat rurale 8 (10.40%) fëmijë kanë qenë të vetëm, 33 (42.90%) kanë qenë fëmijë të parë dhe 36 (46.80%) nuk janë fëmijë të parë. Rezultati nuk është statistikisht i rëndësishëm (p 0.437).

Grafiku 6. Radha e fëmijës me astmë në familje



### 3.4 Vlerësimi i ndikimi të arsimimit të prindërve të fëmijëve në studim

Tabela 18: Niveli arsimor i prindërve të fëmijëve në studim (nëna)

Nëna shkollimi	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Ulët	30 29.70%	46 59.70%	76 42.70%	34.5- 49.7	<0.001
Mesëm	50 49.50%	27 35.10%	77 43.30%	36.4- 51.5	
I lartë	21 20.80%	2 2.60%	23 12.90%	7.9- 18.8	
Nuk ka	0 0.00%	2 2.60%	2 1.10%	0.0- 3.0	

Në studimin tonë nënat e fëmijëve me astmë (Tabela 18, Grafiku 7) që kanë pas shkollim të ulët janë 76 (42.70%) nëna, shkollim të mesëm 77 (43.30%) nëna, shkollim të lartë 23 (12.90%) nëna dhe nuk kanë pas fare shkollim 2 (1.10%) nëna. Nënat e fëmijëve nga vendet urbane që kanë pas shkollim të ulët janë 30 (29.70%) nëna, shkollim të mesëm 50 (49.50%) nëna dhe shkollim të lartë 21 (20.80%) të nënave. Nënat e fëmijëve nga zonat rurale që kanë pas shkollim të ulët janë 46 (59.70%) nëna, shkollim të mesëm 27 (35.10%) nëna, shkollim të lartë 2 (2.60%) nëna dhe 2 (2.60%) nëna nuk kanë pasur shkollim. Ky rezultat është statistikisht i rëndësishëm (p 0.001)

Për sa i përket nivelit arsimor të nënave të fëmijëve të sëmurë me astmë predominon në zonat urbane arsimimi i mesëm dhe i lartë ndërkohë që në zonat rurale predominon arsimimi i ulët dhe i mesëm, por nuk vërehet ndryshim i rëndësishëm në prevalencën e astmës në zonat urbane dhe rurale në prindët me arsim të mesëm dhe të lartë, ndërkohë që prevalenca e astmës në prindët me arsim të ulët është më e lartë në zonat rurale duke përbërë një ndryshim të rëndësishëm. ( shih tabelat 18, 19, grafikun 7). Në shumë studime niveli socio-ekonomik ka treguar që ka qenë i lidhur në mënyrë negative dhe pozitive me astmën por nuk është shumë e qartë se cilët faktorë janë përcaktues për diferencimin social. Këto rezultate kontradiktore tregojnë nevojën për studime sistematike në këtë drejtim. Në përgjithësi të dhënat sugjerojnë një prevalencë më të lartë të astmës në familjet në nivel të ulët social ekonomik si në nivel individual edhe në nivel komunitar (158,159,160). Të




dhënat nga UK Millennium Cohort Study tregojnë se fëmijët e nënave pa arsim të lartë më shpesh kanë fishkëllima dhe astmë krahasuar me fëmijët e nënave me arsim të ulët (161,162) Ndërsa te fëmijët me nivel socio ekonomik më të lartë testet kutane alergologjike janë më shpesh pozitive se sa fëmijët me nivel socio ekonomik të ulët që rritë rrezikun për paraqitjen e sëmundjeve alergjike (163)

Tab 19: Niveli arsimor i prindërve të fëmijëve në studim( babai)

Baba shkollimi	vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Ulët	12 11.90%	17 22.10%	29 16.30%	10.9- 21.8	<0.001
Mesëm	54 53.50%	51 66.20%	105 59.00%	52.1- 66.7	
I lartë	35 34.70%	6 7.80%	41 23.00%	16.4- 28.5	
Nuk ka	0 0.00%	3 3.90%	3 1.70%	0.0- 4.2	

*Në studimin tone baballarët e fëmijëve me astmë me shkollim të ulët kane qene 29 (16.30%), me shkollim të mesëm 105 (59.00%) , me shkollim të lartë 41 (23.00%) dhe nuk kan fare shkollim 3 (1.70%). Baballarët nga vendet rurale me shkollim të ulët janë 12 (11.90%), me shkollim të mesëm 54 (53.50%) dhe me shkollim të ulët 35 (34.70%). Baballarët e fëmijëve nga vendet rurale me shkollim të ulët janë 17 (22.10%), me shkollim të mesëm 51 (66.20%),me shkollim të lartë 7 (6.80%) dhe nuk kanë fare shkollim 3 (1.70%). Ky rezultat është statistikisht i rëndësishëm(p 0.001)*

Grafiku 7. Niveli i edukimit të prindërve të fëmijëve në studim(urban/rural)



### 3.5. Vlerësimi i ndikimit të përdorimit të antibiotikëve gjatë vitit të parë të jetës për infeksione respiratore

Disa studime epidemiologjike kanë raportuar një lidhje midis përdorimit të antibiotikëve në vitin e parë të jetës dhe astmës, por rezultatet janë kundërshtuese dhe të ndikuara nga anësi që është vështirë t'i dallosh (shpesh infeksionet respiratore të fëmijës janë të shoqëruara me fiskëllima dhe zakonisht në praktikë përdoren antibiotikë edhe pse këto infeksione janë kryesisht virale(164,165)

Tabela 20. Përdorimi i antibiotikëve gjatë vitit të parë të jetës

Antibiotikë viti I-rë	Total (n=178)	Vendbanimi	
		qytet (n=101)	fshat (n=77)
Po	133 75.10%	74 74.00%	59 76.60%
Jo	44 24.90%	26 26.00%	18 23.40%

Hi katror =0.16, p 0.69

*Antibiotikët janë përdorur në vitin e parë të jetës në 133 (75.10%) të fëmijëve kundrejt 44 (24.90%) të fëmijëve që nuk kanë përdorur. Nga zonat urbane 74 (74.00%) fëmijë kanë përdorur antibiotik dhe 26 (26.00%) nuk kanë përdorur. Nga zonat rurale 59 (76.60%) fëmijë kanë përdorur antibiotik në vitin e parë të jetës dhe 18 (23.40%) fëmijë nuk kanë përdorur. Ky rezultat nuk është statistikisht i rëndësishëm (p 0.69)*

Në studimin tonë nuk shihet që përdorimi i antibiotikëve të ketë ndikuar në prevalencën e astmës, apo të ketë një ndryshim sinjifikant në drejtim të përdorimit të tyre në dy grupet kryesore të fëmijëve të studiuar (Hi-katror=0.16, p=0.69). Si në qytet ashtu edhe në fshat vërehet përqindja e lartë e përdorimit të antibiotikëve në vitin e parë të jetës (respektivisht, 74% dhe 76,60%). ( shih tabelen 20) . Ka të dhëna në literaturë që tregojnë se përdorimi i antibiotikëve në vitin e parë të jetës shoqërohet me më shumë fishkëllimë në moshë të hershme si dhe astëm pas moshës shkollore (166,167,168,169)). Në studimin tonë nuk shihet që përdorimi i antibiotikëve të ketë ndikuar në incidencën e astmës apo të jetë një ndryshim sinjifikant në drejtim të përdorimit të tyre në dy grupet kryesore të fëmijëve të studiuar.

### 3.6. Vlerësimi i ndjeshmërisë alergjike

#### 3.6.1. Vlerësimi i historisë personale për atopi

Tabela 21. Prania e historisë personale për atopi te fëmijët në studim

Sëm atopike	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	Qytet (n=101)	Fshat (n=77)			
Po	41 40.60%	24 31.20%	65 36.50%	29.1- 44.2	0.128
Jo	60 59.40%	53 68.80%	113 63.50%	55.8- 70.9	

*Me histori personale për atopi rezultuan 65 (36.50%) fëmijë, kundrejt 113 (63.50%) fëmijëve pa histori personale për atopi. Nga zonat urbane me histori për atopi janë 41 (40.60%) fëmijë dhe 60 (59.40%) pa të dhëna për histori atopike. Nga zonat rurale janë 24 (31.20%) fëmijë me histori personale për atopi, kundrejt 53 (68.80%) fëmijë pa të dhëna për histori atopie. Ky rezultat statistikisht nuk është i rëndësishëm ( p 0.128)*

Sikurse shihet në tabelën 21 në fëmijët e studiuar për sa i përket pranisë së atopis në anamnezë (dermatit atopik të vërtetuar nga mjeku, rinit alergjik të vërtetuar nga mjeku), na rezulton se fëmijët me astmë nga zonat urbane kanë patur me shpesh histori personale

për atopi krahasuar me ata nga zonat rurale, respektivisht 40,60% dhe 31,20%, por ky ndryshim nuk është i rëndësishëm nga ana statistikore (p 0.128) midis dy grupeve kryesore të marra në studim, sidoqoftë prania e tyre është në një përqindje të rëndësishme të krahasueshme me studimet epidemiologjike në vende të tjera .

Marshi atopik është një i model i vlefshëm për të përshkruar faktin e vërejtur në praktikë të lidhjes së dermatitit atopik, rinitit atopik dhe astmës në disa fëmijë. (170)Shumë studime mbështetin praninë e trendit të sëmundjeve atopike drejt astmës. Përqindja e fëmijëve me ekzemë që më vonë zhvillojnë astmë është studiuar gjërësisht dhe ka në këto studime një variabilitet të madh nga 25% në 80% (171,172,1714,175,176). Studimet epidemiologjike kanë raportuar lidhje të forta midis rinitit dhe astmës, prevalencën e astmës në pacientët me rinit varion nga 10% deri në 40%, në varësi të studimit por është shumë më e lartë se në individët pa rinit apo dermatit atopik (173,177,178,179).

### 3.6.2. Vlerësimi i ndjeshmërisë alergjike të fëmijët në studim

Tabela 22: Vlerësimi i ndjeshmërisë alergjike të fëmijët në studim

Alergjia	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Dematofagoidet	42 42.40%	36 48.00%	78 44.90%	36.4- 51.2	0.775
Polenet	7 7.10%	6 8.00%	13 7.50%	3.6- 11.5	
Epitelet e kafshëve	5 5.10%	2 2.70%	7 4.00%	1.2- 7.9	
Barërat	8 8.10%	4 5.30%	12 6.90%	3.0- 10.9	
Mykrat	4 4.00%	3 4.00%	7 4.00%	1.2- 6.7	
Ushqimore	7 7.10%	2 2.70%	9 5.20%	2.4- 9.1	
Negative	26 26.30%	22 29.30%	48 27.60%	21.1- 34.5	

*Fëmijët me astëm në studimin rezultojnë pozitiv për ndjeshmëri ndaj :*


- *dermatofagoideve 77 (44.90%) fëmijë, prej tyre nga zonat urbane 41 (42.40%) fëmijë dhe nga zonat rurale 36 (48.00%) fëmijë.*
  - *poleneve 13 (7.50%) fëmijë, prej tyre nga zonat urbane 7 (7.10%) fëmijë dhe nga zonat rurale 6 (8.00%) fëmijë.*
  - *epitelit të kafshëve 7 (4.00%) fëmijë, prej tyre nga zonat urbane 5 (5.10%) fëmijë dhe nga zonat rurale 2 (2.70%) fëmijë.*
  - *barërave 12 (6.90%) fëmijë, prej tyre në zonat urbane 8 (8.10%) fëmijë dhe në zonat rurale 4 (5.30%) fëmijë.*
  - *mykrave 7 (4.00%) fëmijë, prej tyre nga zonat urbane 4 (4.00%) fëmijë dhe nga zonat rurale 3 (4.00%) fëmijë.*
  - *Ushqimeve 9 (5.20%) fëmijë, prej tyre nga zonat urbane 7 (7.10%) fëmijë dhe nga zonat rurale 2 (2.70%) fëmijë.*
  - *Testet alergjike negative kanë rezultuar në 48 (27.80%) fëmijë, prej tyre nga zonat urbane 26 (26.30%) fëmijë dhe nga zonat rurale 22 (29.30%) fëmijë.*
- R rezultatet nuk janë statistiki të rëndësishme (p 0.775)*

Bazuar në të dhënat e studimit (tabela 22) rezultojnë se në 44,3% të rasteve të fëmijëve nga zonat urbane dhe në 41,4% të atyre nga zonat rurale janë pozitiv në prick test ndaj dermatofagoideve, pa një ndryshim të rëndësishëm midis dy grupeve, vendin e dytë e zë ndjeshmëria ndaj poleneve e më pas të tjerat. Vlen të shënohet se në 27,6% të fëmijëve nuk është venë re ndonjë ndjeshmëri ndaj alergjeneve të testuar 26% e tyre nga zonat urbane dhe 29% nga ato rurale, pa ndryshim të rëndësishëm midis tyre.

Shumë punime tregojnë se banimi në zonat rurale shoqërohet me një prevalencë më të ulët të ndjeshmërisë alergjike. Një shpjegim i mundshëm i ndjeshmërisë alergjike më të ulët në zonat rurale është zhvillimi i imunotolerancës, ose stimulimi i celulave TH1 dhe frenimi i atyre TH2 si pasojë e ekspozimit më të madh të fëmijëve që jetojnë në zonat rurale ndaj antigjeneve mikrobiale (113,119,180).

Në Grafikon 8 është paraqitur analiza korelative për alergjenët. Analiza është bërë për të dy drejtimet pra për raportin e alergjeneve mes fëmijëve qytet (c1) dhe fshat (c2), dhe kjo vlerë është shumë e lartë dhe me një lidhje të fortë korelative  $r=0.99$ , që do të thotë se ndikimi i alergjeneve kur të krahasohet me të dy rastet për fëmijët nga qyteti apo fshati ishte i lartë.

Grafiku 8. Analiza korelative e alergjenëve të fëmijët në studim



#### 4.0 Vlerësimi i ndikimit të gjinisë dhe Obezitetit tek fëmijët në studim

##### 4.1. Vlerësimi i ndikimit të gjinisë

Tabela 23. Ndikimi i gjinisë të fëmijët në studim

	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Gjinia					
F	51 50.50%	23 29.90%	74 41.60%	33.7- 49.4	0.004
M	50 49.50%	54 70.10%	104 58.40%	50.6- 86.3	

Në studimin tone fëmijë të gjinisë femërore janë 74(41.60%) dhe të gjinisë mashkullore 104 (58.40%) . Nga zonat urbane numri i fëmijëve të gjinisë femërore është 51 (50.50%) dhe të gjinisë mashkullore është 50 (49.50%). Nga zonat rurale janë 54 (70.10%) fëmijë të gjinisë mashkullore dhe 23 (29.90%) të gjinisë femërore(tabela 23). Ky rezultat është statistikisht t rëndësishëm(p 0.004)

Tabela 24. Ndikimi i gjinisë në grup –moshat kyçe(nën 5 vjeç dhe mbi 5 vjeç)

Moshë sipas gjinisë			Vendbanimi		Total	Vlera e Hi-katrorit	Vlera p
			Qytet	Fshat			
deri 5 vjeç	Gjinia	F	9	5	14	0.742	0.422
			37.50%	29.40%	34.10%		
	M	15	12	27			
		62.50%	70.60%	65.90%			
	Total		24	17	41		
			100.00%	100.00%	100.00%		
mbi 5 vjeç	Gjinia	F	42	18	60	8.254 <sup>c</sup>	0.003
			54.50%	30.00%	43.80%		
	M	35	42	77			
		45.50%	70.00%	56.20%			
	Total		77	60	137		
			100.00%	100.00%	100.00%		

Për fëmijët deri 5 vjet nga zonat urbane 9 (37.50%) janë të gjinisë femërore dhe 15 (62.50%) fëmijë janë të gjinisë mashkullore; ndërkohë që nga zonat rurale 5 (29.40%) fëmijë janë të gjinisë femërore dhe 12 (70.60%) të gjinisë mashkullore (Tabela 24). Nuk ka dallim të rëndësishëm statistikor mes dy grupeve sa i përket gjinisë (p 0.442).

Për fëmijë mbi 5 vjet, 42 (54.50%) janë të gjinisë femërore dhe 35(45.50%) të gjinisë mashkullore nga zonat urbane ndërkohë që nga zonat rurale. 18 ( 30.00%) fëmijë janë të gjinisë femërore dhe 42 (70.00%) të gjinisë mashkullore. Rezultatet nuk ndryshojnë në mënyrë të rëndësishme te moshat nën 5 vjeç (p 0.422), ndryshimi është i rëndësishëm te moshat mbi 5 vjeç (p 0.003)

Për sa i përket gjinisë, vërehet se fëmijët meshkuj nga zonat rurale kanë prevalencë më të lartë të astmës me një ndryshim statistikor të rëndësishëm, krahasuar me fëmijët e zonave urbane ( shih tabelen 23 ). Sipas grup moshave vërehet se ky ndryshim është i rëndësishëm vetëm në grup moshën mbi 5 vjeç dhe nuk është i rëndësishëm për fëmijët nën 5 vjeç (shih tabelen 24). Bazuar në të dhënat e literaturës meshkujt në fëmijërinë e hershme zhvillojnë më shpesh se femrat astmë por më pas femrat janë më të predispozuar se meshkujt për të zhvilluar astmë e lidhur kjo me faktorë si shtimi në peshë dhe sidomos ndryshimet hormonale (181,182).

## 4.2. Vlerësimi i ndikimit të obezitetit

Për sa i përket obezitetit vlen të shënohet se fëmijët e diagnostikuar me astmë kanë qenë kryesisht me peshë normale në 80% të rasteve, mbipeshë në 10.40% të rasteve dhe vetëm një fëmijë ka qenë obez; të dhëna këto, që janë mjaft të kufizuara për të gjykuar mbi ndikimin e obezitetit.

Tabela 25: Ndikimi i Obezitetit te fëmijët në studim(urban/rural)

BMI Percentilet	Total (n=178)	Vendbanimi	
		qytet (n=101)	fshat (n=77)
< percentilin 85	141 79.20%	73 72.30%	68 88.30%
➤ Percentil 85-95 (mbipeshe)	36 20.20%	28 27.70%	8 10.40%
➤ Percentilin 95 (Obez)	1 0.60%	0 0.00%	1 1.30%

Hi katror =9.22, p 0.01

*Fëmijë me BMI <18 (< percentilin 85) (Tabela 25) janë 141 (79.20%), prej tyre 73 (72.30%) fëmijë nga zonat urbane dhe 68 (88.30%) fëmijë nga zonat rurale. Fëmijë me BMI 18.5-24.9 (percentile 85-95) janë 36 (20.20%) fëmijë, prej tyre 28 (27.70%) fëmijë nga zonat urbane dhe 8 (10.40%) fëmijë nga zonat rurale. Fëmijë me BMI 25-29.9 (> percentilin 95) është 1 fëmijë (0.60%) nga zona rurale me 1.30%.*



Tabela 26.Ndikimi i Obezitetit te grup moshat kyce(nën 5 vjeç dhe mbi 5 vjeç)

mosha_new			Vendbanimi		Total	Vlera e Hi-katrorit	Vlera p
			qytet	Fshat			
deri 5 vjeç	BMI	<18.5	19	15	34	.578 <sup>a</sup>	0.374
			79.20%	88.20%	82.90%		
		18.5-24.9	5	2	7		
	20.80%	11.80%	17.10%				
	Total	24	17	41			
			100.00%	100.00%	100.00%		
mbi 5 vjeç	BMI	<18.5	54	53	107	9.004 <sup>c</sup>	<b>0.011</b>
			70.10%	88.30%	78.10%		
		18.5-24.9	23	6	29		
	29.90%	10.00%	21.20%				
	Total	77	59	136			
			100.0%	100.0%	100.0%		

*Fëmijët nën 5 vjeç (tabela 26) nga qyteti me BMI <18.5 janë 19 (79.20%) fëmijë, me BMI 18.5-24.9 janë 5 (20.80%) fëmijë. Fëmijë nga fshati me BMI <18.5 janë 15 (88.20%) fëmijë, me BMI 18.5-24.9 janë 2 (11.80%) fëmijë. Fëmijë mbi 5 vjet nga qyteti me BMI <18.5 janë 54 (70.10%) fëmijë, me BMI 18.5-24.9 janë 23 (29.90%) fëmijë, ndërsa fëmijë nga fshati me BMI <18.5 janë 53(88.30%) fëmijë, me BMI 18.5-24.9 janë 6(10.00%) fëmijë .*

Në të dhënat tona tërheq vëmendjen fakti që obeziteti nuk përbën problem në fëmijët tanë me astmë, por problem është prevalenca e lartë e fëmijëve nën peshë në të dy grupet e fëmijëve urbane dhe rurale. Fëmijët me astmë dhe BMI normale janë në mënyrë të rëndësishme me prevalencë më të lartë në zonat urbane për grup moshat > 5 vjeç, e lidhur kjo ndoshta me kontrollin më të mirë të shtimit në peshë në zonat urbane. Këto të dhëna reflektojnë kulturën në mënyrën e ushqyerjes së fëmijëve por nuk lidhet me objektivat e studimit tonë.

Bazuar në të dhënat e literaturës astma ka prevalencë më të lartë te fëmijët obezë krahasuar me fëmijët nën peshë apo peshë normale, sidomos te gjinia mashkullore (183,184,185) por studimi ynë në këtë drejtim ka të dhëna të pavlerësueshme.

## 5.0. Vlerësimi i ndikimit të faktorëve ambientalë

### 5.1.Vlerësimi i ndikimit të faktorëve ambientalë të brendshëm

#### 5.1.1.Vlerësimi i ndikimit të mënyrës së ngrohjes dhe gatimit

Për sa i përket mënyrës së ngrohjes tërheq vëmendjen se pjesa më e madhe e fëmijëve të sëmurë si në qytet edhe në fshat në familje përdorin për ngrohje dru dhe për gatim gaz.

Tabela 27 .Mënyra e ngrohjes në familjet e fëmijëve me astmë

Ngrohja	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	Qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Elektrike	35 34.70%	2 2.60%	37 20.80%	15.8- 27.9	<0.001
Qëndrore	10 9.90%	5 6.50%	15 8.40%	4.2- 12.1	
Dru	53 52.50%	63 81.80%	116 65.20%	57.6- 72.1	
Thëngjill	3 3.00%	7 9.10%	10 5.60%	2.4- 9.1	


*Familjet e fëmijëve me astmë (Tabela 27, Grafiku 9) të cilat kanë përdorur rrymën elektrike për ngrohje janë 37(20.80%), prej tyre 35 (34.70%) familje janë nga zonat urbane dhe 2 (2.60%) nga zonat rurale. 15 (6.50%). Familje që përdorin ngrohje qëndrore, janë 10 (9.90%) nga zonat urbane dhe 5 (6.50%) nga zonat rurale. Familje që përdorin ngrohje me dru janë 116 (65.20%), prej tyre 53(52.50%) nga zonat urbane dhe 63 (81.80%) nga zonat rurale. Familje përdorin ngrohje me thëngjill janë 10 (5.60%), prej tyre 3 (3.00%) nga zonat urbane dhe 7 (9.10%) nga zonat rurale. Ky rezultat është statistikisht i rëndësishëm ( p 0.001)*

Tabela 28. Mënyra e gatimit në familjet e fëmijëve me astmë

Zierja	Vendbanimi		Total (n=178)	CI 95%	Vlera p
	qytet (n=101)	fshat (n=77)			
Elektrike	43 42.60%	7 9.10%	50 28.10%	21.1- 34.5	<b>&lt;0.001</b>
Gaz	50 49.50%	60 <b>77.90%</b>	110 61.80%	55.2- 69.7	
Dru	7 6.90%	7 9.10%	14 7.90%	4.2- 12.1	
Thëngjill	1 1.00%	3 3.90%	4 2.20%	0.0- 4.2	

Familjet e fëmijëve me astmë (tabela 28, Grafiku 9), të cilat përdorin për gatim rrymën elektrike janë 50 (28.10%) familje, prej tyre 43 (42.60%) nga zonat urbane dhe 7 (9.10%) nga zonat rurale. Familje përdorin gazin për gatim janë 110 (61.80%), prej tyre 50 (49.50%) janë nga zonat urbane dhe 60 (77.90%) nga zonat rurale. Familje që përdorin drurin për gatim janë 14 (7.90%), prej tyre 7 (6.90%) janë nga zonat urbane dhe 7 (9.10%) nga zonat rurale. Familje që përdorin thëngjillin për gatim janë 4 (2.20%), prej tyre 1 (1.00%) nga zona urbane dhe 3 (3.90%) nga zonat rurale. Ky rezultat është statistikisht i rëndësishëm ( $p < 0.001$ ).

Grafiku 9. Mënyra e ngrohjes dhe gatimit të fëmijët në studim



